



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

Dokument parlamentar

**PROCESVERBAL**

Datë 16.07.2014, ora 09:30

**Drejton mbledhjen**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit
2. Projektligji “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,
3. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” të ndryshuar”.
4. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës” të ndryshuar”.

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Silva Caka, Nard Ndoka, Vexhi Muçmataj, Blendi Klosi dhe Tom Doshi.

**Mungojnë:**

Oerd Bylykbashi, Mark Frroku, Arben Ristani, Edi Paloka, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Gjovalin Bzheta, Tahir Muhedini, Mhill Fufi dhe Fatmir Mediu.

**Të ftuar:**

Idlir Peci - Zëvendësministër i Drejtësisë.

Sokol Pasho - përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë.

Edlira Jorgaqi - përfaqësuese nga Ministria e Drejtësisë.

## HAPET MBLEDHJA

**Fatmir Xhafaj** – Mirëdita!

Fillojmë me mbledhjen e komisionit. Meqenëse kuorumi është i plotësuar, fillojmë sipas Rregullores.

Fillojmë me rendin e ditës, i cili ka kohë që është i njohur për shkak se është miratuar në kalendarin e punës së komisionit, por është bërë dhe publik. Ky rend dite ka 3 projektligje të rëndësishme të fushës së drejtësisë, si:

Projektligji “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” të ndryshuar”,

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës” të ndryshuar”.

Nga Ministria e Drejtësisë janë të pranishëm zëvendësministri, zoti Ildir Peçi, zonja Jorgaqi, drejtore e Kodifikimit dhe zoti Pasho, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë.

Faleminderit, që jeni prezente! Fillimisht do të fillojmë me projektligjin e parë: “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Do të dëgjojmë Ministrinë e Drejtësisë, që është inicuese e këtij projekti të sjellë nga qeveria.

Zoti Peçi.

**Idlir Peçi** - Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Në fokusin e qeverisë është përmirësimi i cilësisë së shërbimeve publike dhe verifikimi i cilësisë së tyre nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për ta rikthyer nëpunësin e administratës në shërbim të qytetarëve. Në këtë kuadër është ndërmarrë nisma për miratimin e ndryshimeve në të drejtën procedurale administrative. Qëllimi kryesor i projektligjit, Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë është nga njëra anë t’i sigurojë administratës publike kapacitetin ligjor për të

zgjidhur paqartësitë dhe konfliktet, lidhur me situatën faktike dhe ligjore në mënyrë sa më eficiente, duke respektuar sundimin e së drejtës.

Nga ana tjetër ky projektligj synon t'i sigurojë qytetarit mjetet e duhura e të nevojshme për t'u mbrojtur dhe kërkuar të drejtat e tij. Ministria e Drejtësisë ka hartuar projektligjin e ri në bashkëpunim me misionin SIGMA dhe me asistencën teknike të BE-së.

Sipas raportit të fundit të progresit për Shqipërinë të lëshuar nga KE-ja, reforma në administratën shtetërore përbën një prioritet kyç dhe kërkohet miratimi i ligjit për procedurat administrative. Gjithashtu miratimi i tij është përfshirë dhe në një nga 5 prioritetet e udhërrëfyesit për integrimin në BE.

Hartimi i këtij ligji është bazuar edhe në një ndër parimet më të rëndësishme të teknikës legjislativë, e konkretisht harmonizimit të një projektligji me kuadrin ligjor hyn në fuqi. Konkretisht është pasur në konsideratë unifikimi i Kodit të Procedurave Administrative me ligjet e reja të miratuara në këtë fushë, si për shembull ligji “Për nëpunësin civil” dhe aktet e miratuara bazë për zbatimin e tij, gjithashtu, dhe ligji “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative, gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”. Në hartimin e këtij projektligji Ministria e Drejtësisë ka pasur në konsideratë dhe ka aplikuar praktikën më të mirë të vendeve evropiane për procesin e konsultimit me qëllim pasjen e një produkti sa më cilësor dhe sa më pak të kundërshtueshëm. Në mënyrë që procesi i hartimit të këtij kodi të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe cilësor janë ftuar ekspertët më të mirë vendas, si dhe një sërë partnerë ndërkombëtarë si përfaqësi e OSBE-së në Shqipëri, delegacioni i BE-së, ekspertë të së drejtës së BE-së, si dhe organe e institucione kombëtare, duke filluar nga Unioni i Gjyqtarëve, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës dhe Fakulteti i Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Të gjitha këto kanë paraqitur komentet e tyre të cilat janë reflektuar në projektligjin që ju keni para jush sot. Projektligji është bashkërenduar gjithashtu dhe me të gjitha ministritë e linjës dhe është publikuar edhe në faqen e Ministrisë së Drejtësisë për konsultim publik.

Kodi aktual i Procedurës Administrative parashikon disa rregulla procedurale shumë të ndërlikuara dhe të detajuara, të cilat mund të pengojnë zhvillimin dhe

modernizimin e nevojshëm të administratës publike. Kjo ka sjellë vështirësi gjithashtu dhe në zbatimin në praktikë të tij. Prandaj, në radhë të parë, kjo ka bërë që të lindë nevoja për rishikim të kodit dhe për shkak të ndërhyrjes masive në të gjitha dispozitat e kodit, qoftë në formulimin e tyre, nga pikëpamja e teknikës legislative, qoftë nga pikëpamja substanciale në përmbajtjen e tyre është një nga arsyet përse ne kemi bërë një kod të ri dhe jo thjesht një amendim të kodit.

Gjithashtu, janë shtuar një sërë dispozitash të reja që e bëjnë të pashmangshme nevojën për një kod të ri. Kjo siguron koherencën dhe garantimin e sigurisë ligjore, parim tejet i rëndësishëm kushtetues, si dhe veçanërisht në drejtim të konsolidimit të parimeve bazë të shtetit të së drejtës si përgjegjshmërisë, besueshmërisë dhe eficiencës. Transparenca, gjithashtu, dhe siguria ligjore në vendimmarrje, si dhe standardet e legjislacionit cilësor kërkojnë një sistem koherent dhe të unifikuar të procedurave administrative. Përmbajtja e të gjitha rregullave procedurale në të njëjtin ligj është më e përshtatshme për nëpunësit e organeve publike nga ana tjetër, si dhe për qytetarët. Pra, për këto arsye ka lindur, siç thashë nevoja për propozimin e një kodi të ri në vend të një ligji amendues, i cili bie në kundërshtim me misionin që i atribuohet kësaj reforme dhe që është përmirësimi i eficiencës së ligjit që normon procedurat administrative në vendin tonë. Një ligj amendues do të shkaktonte gjithashtu konfuzion, sipas mendimit tonë, dhe do të cenonte drejtpërdrejt parimin e sigurisë juridike.

Për më tepër, gjithashtu, është synuar përmirësim i përgjithshëm i dispozitave të tij dhe në aspektet e teknikës legislative dhe zbatim të kësaj të fundit, masa e ndryshimeve është e tillë që kërkon ndërmarrjen e një nisme për një kod të ri. Dua të përmend disa risi nga ky kod. Nuk mund t'i futem të gjitha risive, sepse, siç thashë, është ndërhyrë pothuajse në të gjitha dispozitat, por disa nga risitë që ia vlen për t'u përmendur është qartësimi i strukturës së Kodit të Procedurës Administrative duke lehtësuar leximin, zbatimin dhe interpretimin e tij. Siç e përmenda dhe më parë, ka qenë qëllimi kryesor dhe koherenca e kodit dhe e ligjit. Kodi i ri, gjithashtu, sqaron se vullneti i administratës manifestohet jo vetëm në formë e akt-vendimit tradicional të njëanshëm të marrëdhënieve ndërmjet qytetarëve dhe organeve publike, por mbulon të gjithë format e ndryshme ligjore, disa prej të cilave janë të reja dhe për herë të parë janë futur në legjislacionin shqiptar. Për shembull, kontrata administrative në institut ligjor i mirëdetajaur nga

projektligji. Kontrata administrative në ndryshim nga kodi aktual rregullohet, gjithashtu, në një kre të veçantë dhe në këtë kre i jep mes të tjerash kuptimin e kontratës zëvendësuese kontratës administrative nëpërmjet organeve publike, si dhe ndryshimit të prishjes ose tërheqjes nga kontrata administrative, zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në të tilla raste, si dhe kompensimit të humbjes së shkaktuar palës tjetër. Akti real është gjithashtu një diçka tjetër, veprime të shumta si shpërndarjen e informacionit, paralajmërim të qytetarëve kundër rrezikut publik, publikime e vendime të ekspertëve.

Kryerja e tërthortë e shërbimeve është një tjetër risi, adreson probleme krejtësisht të reja ligjore dhe rreziqet për qytetarët që dalin nga tendenca e shtetit për shpërndarjen e shërbimeve publike, për ofruesit e shërbimeve private. Sigurisht organet publike mund të bëjnë gjithashtu përdorimin e formave private ligjore për të arritur objektivat e tyre. Projektligji përfshin rregullimet ligjore të reja, të cilat synojnë njësimin e këtyre dispozitave me ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile lidhur me komunikimin elektronik, si dhe pikat e shërbimit me një ndalesë të ashtuquajtur *one stop shop*, të cilat janë trajtuar gjerësisht në projektligj.

Një tjetër risi që mund të themi është sanksionimi i së drejtës së një organi publik për t'i kërkuar ndihmë administrative një organi tjetër publik për kryerjen e një apo disa veprimeve të nevojshme në kuadër të procedimit administrativ, duke lënë në diskrecionin e organit publik për të vendosur se kujt organi tjetër të administratës duhet t'i drejtohet për ndihmë administrative. Nocioni i pajtimit të palëve është një nocion tjetër i futur gjatë zhvillimit të një procedimi administrativ me palët kundërshtare. Projektligji sanksionon mjetet e kërimit të provës, kuptimin e tyre, vlerësimin e provave dhe paraqitjen e provave para një organi tjetër përmes dispozitave të qarta dhe, mbi të gjitha, duke parashikuar shprehimisht kuptimin dhe duke renditur mjetet e kërimit të provës për një proces sa më transparent, gjë e cila në kodin e aktual mungonte.

Janë parashikuar rregulla të detajuara, gjithashtu, në lidhje me njoftimin e veprimeve administrative që rrjedhin direkt nga parimi i sundimit të ligjit. Njoftimi trajtohet në një pjesë më vete dhe fusha e zbatimit e sistemit të ri të njoftimeve është më e gjerë se ajo e parashikuar në kodin aktual. Dispozitat e kësaj pjese përmirësojnë situatën e palëve të një procedure administrative, personat ose palët e përfshira gjithashtu në procedurë, si dhe të organit publik. Përcaktohen gjithashtu forma të ndryshme të njoftimit

të cilat kanë qenë, janë futur dhe disa të reja gjithashtu. Projektligji parashikon procedura të hollësishme për ankimin administrativ, kushtet, afatet për paraqitjen, efektet, procedurën e shqyrtimit të ankimit ndaj aktit, refuzimit administrativ të mosveprimit. Pra, ka një zgjerim, gjithashtu, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij të ligjshme cenohen nga një veprim ose mosveprim dhe njëkohësisht përcakton subjektet që legjitimohen për ushtrimin e kësaj të drejte.

Tërësisht të reja janë parashikimet lidhur me procedurën e ankimit administrativ ndaj refuzimit administrativ dhe mosveprimit administrativ. E drejta e ankimit zgjerohet edhe për mbajtësit e interesave publike të autorizuar nga ligji, si dhe mbajtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse pretendojnë se këto interesa cenohen nga një veprim apo mosveprim. Ky rregullim është i një rëndësie të veçantë pasi mundëson të drejtën e kontrollit të brendshëm të veprimeve administrative duke mbrojtur njëkohësisht interesat individuale dhe publike.

Projektligji jep për herë të parë kuptimin e aktit të garancisë, aktit administrativ me kusht, afat apo detyrim me shtesë, kryerjes së tërthortë të shërbimeve publike që përmenda dhe më përpara. Gjithashtu, rregullon zbatimin dhe ekzekutimin e aktit administrativ në një pjesë më vete dhe kjo pjesë rregullon fazën e fundit të procedurës administrative, ekzekutimin e një akti administrativ që nuk është zbatuar në mënyrë vullnetare. Është shumë e rëndësishme për sundimin e së drejtës gjithashtu që vendimet administrative të ekzekutohen. Në këtë mënyrë ekuilibrohen interesat e palëve për një procedurë të drejtë dhe të kuptueshme të ekzekutimit të interesave të administratës publike për një procedurë administrative të shpejtë, efektive dhe eficiente.

Gjithashtu, projektligji thekson rëndësinë e parimit të proporcionalitetit, i cili ritheksohet në ekzekutimin e aktit administrativ, që do të thotë se aktet administrative do të ekzekutohen në mënyrën dhe mjetet e ekzekutimit të cilat ndërsa sigurojnë ekzekutimin shkaktajnë dëmin më të vogël të mundshëm ndaj të drejtave dhe interesave të ligjshme të subjektit ndaj të cilit kryhet ekzekutimi.

Një pikë e fundit, që ia vlen për t'u përmendur është se projektligji trajton kundërshtimin e veprimeve të tjera administrative. Qëllimi i kundërshtimit administrativ është shqyrtimi i ligjshmërisë ose i ushtrimit të diskrecionit të një veprimi ose mosveprimit të ndryshëm nga akti administrativ, apo të një veprimi ose mosveprimi të

subjektit publik ose privat, sipas praktikave të kodit. Në kod gjejnë rregullim dhe kundërshtim administrativ, në rastin e veprimit tjetër administrativ, kundërshtim administrativ në rastin e kryerjes së tërthortë të shërbimeve publike, forma e kundërshtimit administrativ dhe afati, si dhe procedura për zgjidhjen e kundërshtimit administrativ. Kemi besimin se kjo qeveri po i ofron administratës publike dhe qytetarit një kod të tillë administrativ që do ta çojë administratën publike në majat e tij.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Fjalën e ka relatori, zoti Subashi.

**Armando Subashi** - Faleminderit!

Si fillim do të doja të përgëzoja dhe të falënderoja Ministrinë e Drejtësisë për këtë nismë dhe draftin që ka sjellë. Është për t'u vlerësuar, sepse jam i bindur që është një punë e gjatë, e thellë, e konsiderueshme, është një punë që është bërë në bashkëpunim me misionin SIGMA dhe me asistencën teknike të BE-së. Nga kjo pikëpamje drafti që ka ardhur ka një rëndësi shumë të madhe dhe jetike për mënyrën se si duhet të funksionojë e gjithë administrata shtetërore në Shqipëri. Pa dyshim që ne sot kemi një ligj, madje edhe në emërtesë kemi të njëjtin ligj, Kodin e Procedurave Administrative. Për hir të së vërtetës është një ligj që është miratuar në maj të vitit 1999, pra pas miratimit të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë. Tashmë kanë kaluar rreth 15 vjet nga miratimi i atij ligji. Është zbatuar gjerësisht në veprimtarinë e përditshme të administratës shtetërore, por sigurisht ka pasur dhe ka problematikat e veta, të cilat jo vetëm janë evidentuar gjatë gjithë këtyre viteve dhe që pa dyshim gjejnë pasqyrim në draftin e ri që ka sjellë ministria, por në një lloj kuptimi vetë koha në të cilën është miratuar pa dyshim që ka krijuar probleme në raport me disa nga standardet evropiane të këtij drafti dhe të mënyrës se si duhet të funksionojë administrata shtetërore.

Në fakt, e thënë pak më thjesht dhe pak më shqip, ndoshta edhe për publikun e gjerë, ky kod është ligji bazë mbi të cilin mbështetet e gjithë veprimtaria e përditshme e çdo qelize të administratës shtetërore që nga ato më të thjeshta dhe deri tek pjesa më e lartë e administratës shtetërore. Çdo veprim administrativ që kryhet, çdo akt administrativ që del, çdo marrëdhënie administrative që krijohet midis institucioneve, apo midis institucioneve dhe qytetarëve pa dyshim që në pjesën dërrmuese të tyre rregullohen nga

ky kod, rregullohen nga ky ligj. Kështu që në këtë kuptim do të thosha që ligji është i një rëndësie themelore. Pa dyshim që do të gjejmë të gjithë instrumentet e duhura, të gjithë ekuilibrat e duhur. Sigurisht që kemi bërë një hap shumë të madh përpara, jo vetëm në mënyrën se si duhet të punojë dhe të funksionojë administrata shtetërore, dhe se si duhet ta formalizojë të gjithë veprimtarinë e vet të përditshme, por pa dyshim kemi bërë një hap të madh përpara dhe në raportet dhe marrëdhëniet e saj, edhe me mënyrën se si duhet të sillemi me shtetasit, me qytetarët e këtij vendi.

Zëvendësministri bëri prezantimin e vet. Midis të tjerash parashtroi edhe risitë që sjell ky projektligj në raport edhe me projektligjin ekzistues. Unë jam plotësisht dakord me të gjithë ato që u thanë, nuk dua të bëj përsëritje këtu. Pa dyshim që të gjitha ato janë risi, janë vlera të shtuara që sjell drafti i ri, jo vetëm në raport me ligjin ekzistues, por edhe në raport me disa standarde tashmë të pranuar të BE-së. Vetë fakti që miratimi i këtij drafti është një nga prioritetet që ka përcaktuar qeveria shqiptare, edhe në raport me axhendën që ne kemi me integrimin evropian, tregon më së miri rëndësinë shumë të madhe që ka ky kod, që ka ky ligj lidhur me miratimin e vet.

Unë do të ftoja të gjithë kolegët që ne ta mbështesim këtë draft. Unë do të isha i mendimit që për vetë volumin që ka ligji dhe pa dyshim edhe rëndësinë e madhe që ka, ne sot, sigurisht dhe pas diskutimeve që do të bëhen, ta miratonim në parim dhe pa dyshim pastaj të marrim të gjithë kohën e nevojshme për të diskutuar nen për nen, në raport me projektligjin dhe pastaj pas atij diskutimi mund të shohim edhe problematika të ndryshme qoftë të teknikës legjislativë, qoftë edhe të rakordimit të këtij drafti me ligjet e tjera që tashmë kemi miratuar, qoftë ligji “Për statusin e nëpunësit civil”, qoftë ligji për funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative dhe, në këtë kuptim t’i bashkërendojmë të gjitha këto, t’i rakordojmë me njëri-tjetrin dhe në mbyllje të këtij procesi të kemi një kuadër të plotë ligjor në raport me të gjithë pjesën e administratës shtetërore, në raport me veprimtarinë e saj, por edhe në raport me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të ndryshme që mund të lindin nga i gjithë ky proces.

Për ta mbyllur, se nuk dua të zgjatem, se të gjithë kolegët e kanë relacionin përpara. Edhe një herë do të doja që t’i përgëzoja të gjithë aktorët dhe faktorët që kanë

marrë pjesë në këtë draftim. Sigurisht do të ftoja të gjithë kolegët që ta miratojnë draftin në parim për t'u rezervuar pastaj në miratimin nën për nën.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

Ka pyetje? Po, zoti Braho.

**Spartak Braho** –Unë kam një pyetje. Duke shfrytëzuar rastin shprehem për mbështetjen totale të këtij ligji mjaft të rëndësishëm. Mendja më shkon realisht te puna që duhet të bëjë administrata shtetërore për njohjen e këtij ligji të rëndësishëm, që është Kushtetuta e administratës. Tani si, qysh, tek, nuk jam në gjendje të them ndonjë mendim konkret, por ndoshta Ministria e Drejtësisë duhet të bëhet promotore e propagandimit të këtij ligji mjaft të rëndësishëm. Dhe këtu e mbyll këtë pjesë. Kam një pyetje, një merak. Pse i është dhënë afati një vit për hyrjen në fuqi? Si e keni gjykuar?

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Idlir Peçi** – Faleminderit, zoti Braho!

Fatkeqësisht pjesën e dytë të pyetjes nuk e dëgjova për shkak të fonisë.

**Spartak Braho** - Pse i është dhënë afati një vit projektligjit për të hyrë në fuqi?

**Idlir Peçi** – Faleminderit, për mbështetjen, por dhe për pyetjen që bëtë. Është një pyetje e rëndësishme. Siç e thatë dhe ju, është Kushtetuta e administratës publike, duhet të njihet në majë të gishtave nga administrata për t'u përvetësuar, në radhë të parë, dhe pastaj për t'u zbatuar në atë mënyrë që ne mendojmë se duhet të zbatohet, të paktën ato risi që ne kemi sjellë të zbatohen ashtu siç duhet të zbatohen. Për këtë arsye janë siguruar fonde, jemi pjesë e programit IPA 2, ku janë parashikuar gjithashtu trajnime të administratës publike. Afati 1-vjeçar është pikërisht kjo arsyeja që administratës publike t'i lejohet koha e duhur. Të gjithë atyre personave që në punën e tyre të përditshme do të kenë të bëjnë me këtë kod, t'i lejohet koha e duhur për t'u njohur me këtë kod, për t'u trajnuar mbi zbatueshmërinë e këtij kodi, si dhe për ta përvetësuar atë për ta bërë të tyren.

Gjithashtu, në raundet konsultative që kemi bërë kemi organizuar disa raunde konsultative. Një nga këto ka qenë gjithashtu dhe me administratën publike, sidomos me të gjithë ata drejtorë, përfaqësues nga drejtori juridike të ministrive të linjës, por dhe të agjencive të ndryshme të pavarura kushtetuese, të cilat do të kenë të bëjnë me këtë ligj. Tashmë ka filluar njohja e tyre me këtë ligj. Të paktën e disa nga strukturat e

administratës, sidomos të zemrës së tyre që janë drejtoritë juridike, të cilat janë njohur me ligjin, kanë dhënë komentet e tyre, kanë qenë pjesë e diskutimeve dhe konsultimeve. Pra, mund të them se ai proces trajnimi ose procesi i njohjes së administratës me këtë ligj ka filluar tashmë dhe do të vazhdojë në një vit dhe kjo ka qenë edhe arsyeja përse ne kemi kërkuar një vit.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

Kam unë një pyetje. Puna për përgatitjen e këtij ligji ka zgjatur shumë në kohë. Ndoshta mund të mos jetë dhe shumë e saktë. Dhe është diskutuar gjatë edhe në një fazë të dytë për ta riparë ligjin, qoftë edhe në mënyrën e të shkruarit. Pse ka ndodhur ky fenomen?

**Idlir Peçi** - Faleminderit!

Ky projekt, në mos gabohem, ka filluar në vitin 2011. Ka qenë një projekt i iniciuar me mbështetje të BE-së, me projektin SIGMA. Ka qenë një grup pune i cili ka punuar mbi këtë ligj. Për rishikimin e tij ka qenë, gjithashtu, i ftuar një ekspert gjerman, një profesor i së drejtës administrative, i cili në bashkëpunim me ekspertë shqiptarë kanë hartuar këtë ligj. Për arsye që ndoshta nuk duhet pyetur kjo administratë, por administrata e kaluar, është mbajtur zvarrë dhe nuk i është dhënë shtysë këtij ligji. Me ardhjen e kësaj administrate në pushtet, duke marrë parasysh dhe kërkesat e BE-së, që është një nga prioritetet kyçe, është një nga pesë prioritetet e udhërrëfyesit për integrimin evropian, ne bëmë atë që nuk është bërë për 3 vjet, që ky kod është mbajtur nëpër sirtarë. Ka pasur llojlloj komentesh, të cilat thonë që nuk është bërë asgjë. Por ju siguroj, zoti Xhafaj, që stafi i Ministrisë së Drejtësisë me ekspertët më të mirë të fushës, por dhe me asistencën e ndërkombëtarëve e kanë rishikuar projektin e SIGMA-s që është bërë. Pothuajse 70%, ose më shumë e draftit fillestar, është rishikuar dhe punuar nga Ministria e Drejtësisë në këta 6-7 muaj. Këtë kemi bërë ne.

Për sa i përket pyetjes që bëtë ju, se përse është zgjatur kaq shumë, kjo është një pyetje që ndoshta nuk na takon të përgjigjemi, sepse ne e gjetëm nëpër sirtarë dhe thjesht e nxorëm nga sirtarët dhe po e sjellim këtu pas 8 muajsh.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka. Ka diskutime?

Relatori na e bëri të qartë dhe kërkesa është e arsyeshme për ta miratuar sot në parim dhe pastaj për ta shqyrtuar me qetësi nen për nen duke qenë se, siç thanë dhe kolegët, ky është një ligj tejet i rëndësishëm.

Ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar? Dakord.

Kush është dakord në parim për miratimin e këtij projektligji? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim dhe Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë dhe e ndërpresim këtu diskutimin për këtë projekt, për të vazhduar pastaj në një kohë të dytë me shqyrtimin nen për nen.

Këtu mbaron dhe pika e parë e rendit të ditës.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

Dokument parlamentar

**PROCESVERBAL**

Datë 16.07.2014, ora 09:30

**Drejton mbledhjen**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” të ndryshuar”.

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Silva Caka, Nard Ndoka, Vexhi Muçmataj, Blendi Klosi dhe Tom Doshi.

**Mungojnë:**

Oerd Bylykbashi, Mark Frroku, Arben Ristani, Edi Paloka, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Gjovalin Bzheta, Tahir Muhedini, Mhill Fufi dhe Fatmir Mediu.

**Të ftuar:**

Idlir Peçi - përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë.

Sokol Pasho - përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë.

Edlira Jorgaqi - përfaqësuese nga Ministria e Drejtësisë.

**Fatmir Xhafaj** - Fillojmë me shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës: projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar”, iniciativë e një grupi deputetësh.

Në emër të grupit që ka iniciuar projektin, fjalën e ka zoti Majko.

**Pandeli Majko** – Besoj se të gjithë kolegët kanë përpara tyre projektligjin e firmosur nga një grup deputetësh, një pjesë e të cilëve janë dhe anëtarë të këtij komisioni.

Që në krye të herës dëshiroj të them se risia kryesore që sjell projektligji është forcimi i normave ekzistuese që ekzistojnë në rregulloren e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Jo vetëm në faktin se të gjitha raportimet e institucioneve ndërkombëtare, por sidomos ajo që është më e rëndësishme në procesin e integritetit evropian të Shqipërisë, nuk besoj se është sekret qoftë për publikun, qoftë për Komisionin e Ligjeve, fakti i keqfunksionimit të KLD-së.

KLD-ja është qeveria e sistemit të drejtësisë, që drejtohet nga Presidenti i Republikës. Kur një këshill i lartë drejtësie nuk respekton rregulloren që ka miratuar vetë, atëherë këtu ngrihen një varg pikëpyetjesh. Kjo na detyron ne, një grup deputetësh, që t’i ofrojmë qoftë parlamentit, qoftë sot për diskutim Komisionit të Ligjeve, një fakt të thjeshtë. Një pjesë të këtyre rregullave, të cilat janë funksionuese dhe janë të detyruara, të miratuara nga vetë KLD-ja, nga rregullat e rregullores t’i ngrenë në nivelin e ligjit.

Kam parasysh sidomos, për shembull, një nga normat ekzistuese, që ekzistojnë në rregulloren e KLD-së dhe ngrihen në fuqinë e ligjit, e kryetarëve të gjykatave, që është miratuar nga vetë KLD-ja me vendimin numër 227/2, datë 28.03.2008.

Tjetër risi në këtë projektligj është fakti që ne normojmë me ligj transparencën e vendimeve dhe gjykimeve që jep KLD-ja edhe për mënyrën e funksionimit, edhe për të mirën e çdo lloji të Këshillit të Lartë të Drejtësie, që do të funksionojë në historinë e mëpasme të këtij vendi. Është e nevojshme që publiku, por jo vetëm ai, të shikojë në mënyrë transparente të gjitha llojet e diskutimeve që janë diskutuar në KLD, në qeverinë e sistemit të drejtësisë dhe sidomos ne identifikojmë edhe zbardhjen e mendimeve kundër.

Një problematikë tjetër, e cila është fiksuar dhe propozuar nga ana e grupit të deputetëve, është një fakt që nuk kërkon të rëndojë, por kërkon të identifikojë një problem, që ka ekzistuar dhe ekziston me një lloj sjelljeje karshi vetvetes, në mënyrë subjektive të anëtarëve të KLD-së. Një anëtar i KLD-së zgjidhet për një mandat 5-vjeçar. Në këtë mandat ai duhet të harrojë se mund të votojë për veten e tij. Pra, duhet t'i jepet fund faktit që zgjidhesh anëtar i KLD-së, zgjidhesh anëtar i qeverisë së sistemit të drejtësisë dhe nëpërmjet zgjedhjes në këtë qeveri t'i mund të shkosh dhe të promovosh veten. Për 5 vjet, ne me ligj i ndalojmë çdo anëtar të KLD-së të promovojë veten. Madje, kjo është e fiksuar qartas deri në fund të mandatit 5-vjeçar dhe në qoftë se jep dorëheqjen, kjo përsëri do të vazhdojë të njihet deri në 5 vjet. Pra, të mos krijojmë lapsuse subjektive të krijuara nga lloket e natyrave të ndryshme, që unë jam anëtar i KLD-së, po jap dorëheqjen dhe po zgjidhem kryetar gjykate. Këto gjëra përfundimisht duhet të mbyllen. U zgjodhe anëtar i KLD-së, për 5 vjet do t'i shërbesh sistemit të drejtësisë dhe jo vetes.

Një problem tjetër, të cilin ne e kemi trajtuar me shumë vëmendje është problemi i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, një varg normash, të cilat bëhen detyruese për këtë inspektorat, për rolin e rëndësishëm që ka ky inspektorat dhe mendoj se në vazhdim, nëse kolegët kanë pyetje, unë mund t'u jap detaje të mirëfillta për këto elemente, por dëshiroj të them se marrëdhënia midis Inspektoratit dhe KLD-së, marrëdhënia e raportimeve të rregullta, transparente të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për veprimtarinë e gjykatësve dhe të mirëfunksionimit të sistemit të drejtësisë është shumë e rëndësishme. Kjo është arsyeja pse ne e kemi sjellë të normuar këtë problematikë.

Po ashtu, ne kemi trajtuar edhe momentet procedurale të sjellja natyrshëm nga ndryshimi i Kushtetutës në parlamentin e kaluar, lidhur me mënyrën e procedimit penal, qoftë për deputetët, qoftë për anëtarët e sistemit të drejtësisë. Ne thjesht kemi trajtuar problemin si zhvillohet mënyra e ndjekjeve penale të gjyqtarëve dhe mënyrën e sjelljes së KLD-së, afateve kohore, afateve procedurale, si KLD-ja duhet të veprojë menjëherë përballë elementeve të natyrave të tilla, siç është ndjekja penale e anëtarëve të sistemit të drejtësisë.

Po ashtu, në nenin 2 të projektligjit parashikohet edhe shtimi i shkronjave “f” dhe “g” në nenin 7 të mbarimit të mandateve, ku anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi shkarkohen për shkelje të Kushtetutës dhe të ligjit. Anëtarët e zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare shkarkohen për shkelje të kushtetutës dhe të ligjit.

Unë e kuptoj që mund të ketë trajtime të natyrave të ndryshme sikur parlamenti po ndërhyr në debatin, ta quajmë kështu deri diku, të nxehtë midis Ministrisë së Drejtësisë dhe KLD-së, por nuk besoj se mund të dalë dikush sot të na thotë që këto janë dy fjali të gabuara, se ndryshe atëherë i bie të themi që anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi mund të bëjnë edhe shkelje të Kushtetutës edhe shkelje të ligjit.

I gjithë sistemi i ndryshimeve që kemi sjellë është në funksion të mirëfunksionimit dhe të akordimit më të mirë të gjithë asaj eksperience pozitive, që ekziston në KLD. Dua ta nënvizoj faktin e eksperiencës pozitive të KLD-së.

Në fund të fundit, ne kemi këtë sistem drejtësie, me të mirat dhe me të këqijat e veta. Këto ndryshime nuk janë për të mallkuar dikë, për të nxjerrë fajtor, për të vënë në bankën e të akuzuarve dikë. Kjo është, siç e thashë në parim, disa norma të rregullores së brendshme të KLD-s i normojmë në ligj duke nxitur mirëfunksionimin.

Ne kemi një varg problematikash, që kanë të bëjnë me shkeljet në vazhdim në KLD . Unë shpresoj që pas miratimit të këtij projektligji këto të kthehen në zero. Nuk besoj se KLD-së i bën nder fakti, për shembull, që ka informacione edhe me shkrim se në kundërshtim me ligjin ka promovuar gjyqtarë, të cilët kanë pasur kërkesë për procedim disiplinor, apo që ka vendosur kryetar gjykate në kundërshtim me ligjin, apo që ka krijuar një sistem të emëruarish me të ashtuquajturën komandim në një varg gjykatash.

Unë shpresoj që ky është një moment subjektiv kalimtar dhe pas miratimit të këtij projektligji, ne do të kemi një funksionim më të mirë të KLD-së, me qëllim që të mirëkuptohet ajo që është domethënëse dhe që ka të bëjë me esencën e ndërhyrjes së Kuvendit në këtë debat. Ne nuk po mbajmë anësi. Ne po i kërkojmë KLD-së të respektojë më mirë rregullat që ka miratuar vetë duke i ngritur ato në fuqinë e ligjit.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Majko!

Kolegët e tjerë që kanë nënshkruar iniciativën mund të marrin fjalën në vijim, por si fillim, po ia jap fjalën relatorit të projektligjit, zotit Subashi.

**Armando Subashi** – Faleminderit, edhe një herë kryetar!

Falënderoj kolegët për këtë iniciativë, që kanë sjellë përpara Kuvendit. Shpreh keqardhjen që për arsye objektive, unë nuk jam pjesë e këtyre propozimeve, por ngushëllohem pak me faktin që jam relator i këtij projektligji dhe që nga kjo pikëpamje jam plotësisht i kënaqur dhe i vetëdijshëm për kontributin, që duhet të japim të gjithë në këtë moment delikat dhe shumë të vështirë në raport me mënyrën si po funksionon KLD-ja, por edhe sistemi i drejtësisë në përgjithësi.

E tha edhe kolegu Majko që KLD-ja është qeverisja e gjyqësorit. Pra, nëse sot ka një situatë të rënduar, ka një mosbesim të theksuar të opinionit publik, të aktorëve dhe faktorëve të ndryshëm, si brenda vendit, ashtu edhe jashtë vendit, nëse janë ngritur dhe po bien kambanat e alarmit për mënyrën si duhet të funksionojë sistemi i drejtësisë për mënyrën si duhet të japë garanci në raport me shtetin ligjor, me sigurinë juridike, për investimet e huaja në Shqipëri, për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut etj., etj., sigurisht një rol në këtë drejtim, pozitiv apo negativ, e ka KLD-ja, si organi kushtetues, i cili mbulon në mënyrë të drejtpërdrejtë dy nivelet e para të sistemit gjyqësor, pra, gjykatat e shkallëve të para dhe gjykatat e apelit.

Si gjyqtar prej shumë e shumë vitesh, por edhe si anëtar i KLD-së, po të bëj një analizë të të gjithë shkaqeve dhe faktorëve, që kanë ndikuar në vite, në gjithë këtë situatë që ndodhet sot sistemi, pa dyshim, që faktorët dhe shkaqet mund të jenë të ndryshme, por unë vazhdoj t'i qëndroj mendimit që rolin kryesor në këtë drejtim e ka dhe duhet ta ketë KLD-ja, pasi aty është vendi ku emërohen gjyqtarët, aty është vendi ku transferohen gjyqtarët, aty është vendi ku promovohen gjyqtarët, aty është vendi ku procedohen gjyqtarët në rastet e shkeljeve të mundshme ligjore, aty është vendi ku emërohen kryetarët e gjykatave, të cilët kanë një rol shumë të rëndësishëm dhe shumë të veçantë në administrimin gjyqësor e kështu me radhë. Nëse të gjitha këto kompetenca kushtetuese dhe ligjore që ka KLD-ja do të kryheshin siç duhet, unë jam i bindur që edhe sistemi i drejtësisë nuk do të ishte në këtë shkallë dhe në këtë nivel mosbesimi që është sot.

Le të kthehemi te drafti që ka ardhur. Unë e thashë që në fillim, e mbështes plotësisht, madje do të thosha që me shumë bonsens dhe dashamirësi, ndoshta në disa aspekte të veprimtarisë së këshillit, mundet që të kishim parashikuar edhe diçka më shumë, dhe unë si relator i këtij projektligji rezervoj gjithë të drejtën që kur të vijë momenti i shqyrtimit nen për nen, të bëj edhe disa propozime të miat në këtë drejtim.

Sigurisht, nuk janë thjesht propozime të miat, janë propozime, që kanë ardhur këto ditë, edhe nga aktorë të ndryshëm, sidomos brenda sistemit, ju them një gjë dhe nuk është ndonjë problem, vetëm gjatë javëve të fundit nga vetë gjyqtarët e Shkallës së Parë dhe të Apelit, unë personalisht, por besoj se edhe një pjesë e kolegëve këtu kemi pasur me dhjetëra *e-maile*, të cilat kanë rënë në dijeni të këtyre ndryshimeve dhe vetë gjyqtarët, në një lloj kuptimi, janë të pakënaqur me mënyrën si ka funksionuar KLD-ja, me mënyrën si ka funksionuar qeverisja e tyre në gjithë këto vite.

Nga njëra anë, më vjen mirë që edhe shumë gjyqtarë, qoftë gjyqtarë të apelit apo të shkallëve të para, na kanë nisur propozime konkrete për të rregulluar edhe fusha të tjera specifike, të veçanta të mënyrës së organizimit dhe të funksionimit të KLD-së.

Sigurisht që për mua ka sens, është shumë pozitive, dhe është për t'u përgëzuar, sepse edhe brenda sistemit të drejtësisë jo të gjithë janë të korruptuar, jo të gjithë janë të paafte. Ka edhe gjyqtarë shumë të mirë, shumë të ndershëm, të cilët në gjithë këto vite nuk janë pajtuar dhe nuk pajtohen me praktikën, shpeshherë, negative që janë ndjekur në KLD.

Ne, tashmë, jemi të njohur me ndryshimet që synon ky projektligj. Kolegu Majko i përmendi në emër të kolegëve deputetë dhe do të thosha se një pjesë e tyre janë përforsim i disa dispozitave aktuale, të cilat nuk janë të parashikuara në ligje, por në rregulloren e funksionimit të KLD-së. Është për të ardhur keq, që edhe pse vetë këshilli me konsensus të plotë ka miratuar një rregullore, ka miratuar disa norma për të mbushur ndoshta boshllëqet ligjore, që kanë ligjet, qoftë ligji i KLD-s, qoftë ligji "Për organizimin e pushtetit gjyqësor", dhe, nga ana tjetër, nuk i ka zbatuar ato norma që ka miratuar vetë.

Sigurisht, rregullorja është rregullore dhe ndoshta këtu justifikimet mund të jenë nga më të ndryshmet, por nëse disa nga këto elemente ne i ngremë në nivelin e ligjit, në norma ligjore, aq më tepër në një ligj të rëndësishëm, siç është ky që miratohet me një

shumicë të cilësuar, me 3/5-at, sigurisht këtu do ta vëmë institucionin dhe vetë këshillin në një pozitë tjetër në raport me respektimin e këtyre normave.

Pa dyshim që problemi i parë, ai i promovimit të një pjese të anëtarëve të këshillit, është problem shqetësues. Ka ndodhur në gjithë këto vite, praktikat janë nga më të ndryshmet. Është pritur sa të mbarojë mandati dhe pastaj është promovuar. Ka pasur promovime gjatë mandatit, pra, gjatë ushtrimit të detyrës brenda afatit 5- vjeçar ka pasur promovime edhe me “hile”, ku mund të kenë dhënë dorëheqjen për t’u promovuar diku tjetër e kështu me radhë.

Kështu që nga kjo pikëpamje, besoj që me këtë që kam parashikuar ose më këtë që kanë sjellë kolegët, i mbyllim derën një herë e mirë këtyre historive në KLD, jo vetëm gjatë kohës që janë në ushtrim të mandatit, por edhe për një periudhë, do të thosha (dhe kjo mund të jetë edhe një lloj propozimi, që unë në fakt do ta sjell), 1 ose 2 -vjeçare pas përfundimit të mandatit, ku anëtarët e KLD-së të mos kenë të drejtën e promovimit.

Sigurisht këtu jemi në të njëjtin mendim edhe me një pjesë të propozimeve, që na kanë ardhur nga vetë gjyqtarët në këtë drejtim. Ajo çka do të thosha, që duhet të meritojë një vëmendje të konsiderueshme, është instituti i mbarimit të mandatit të anëtarëve të KLD-së në raport me shkarkimin e tyre.

Po të shikojmë ligjin e KLD-së mund të jetë ligji i vetëm, i cili ka një boshllëk ligjor në raport me shkarkimin e anëtarëve të KLD-së. Edhe ligji “Për Gjykatën Kushtetuese”, edhe ligji “Për Gjykatën e Lartë, edhe ligje të tjera, të cilat normojnë mënyrën e organizmit dhe të funksionimit të organeve kushtetuese, qoftë edhe të pavarura, madje edhe më të pavarura se KLD-ja, sigurisht që parashikojnë në dispozitat e veta edhe rastet se kur mbaron mandati i një anëtari edhe rastet kur mund të shkarkohet ky anëtar.

Besoj se të gjithë e kuptojmë që këto dy institute nuk janë e njëjta gjë dhe përderisa nuk janë e njëjta gjë, sigurisht edhe rregullimi ligjor i tyre duhet të jetë i veçantë, i ndryshëm dhe parashikimet e rasteve se kur mbaron mandati i një anëtari dhe se kur mund të shkarkohet ai anëtar, duhet të jenë të precizuara saktë në ligj, duhet të jenë të ndara në mënyrë të qartë dhe evidente që të mos krijojnë probleme, sepse duke ardhur pastaj te mbarimi i mandatit, që është edhe mbarimi para kohe ose para afatit të

mandatit, sigurisht që shkaqet nuk mund të jenë të njëjta me ato të cilat mund të parashikohen në rastet e shkarkimit të një anëtarit të KLD-së.

Prandaj, nga kjo pikëpamje, unë rezervoj të drejtën që, kur të vijmë te shqyrtimi nën për nën, të bëj propozimin tim përkatës, ku duhet të kemi një ndarje të pastër midis Institutit të Mbarimit të Mandatit, mbarimit të rregullt, apo dhe para afatit dhe shkarkimit të anëtarëve të KLD-së dhe, pa dyshim, që do të ketë nevojë për modalitete të duhura, pse duhet bërë, kur duhet bërë, si duhet bërë dhe e gjithë kjo duhet parashikuar në raport me parashikimet kushtetuese, parimet kushtetuese, që kanë të bëjnë me balancat midis pushteteve e kështu me radhë.

Një moment tjetër që unë do të vlerësoja është edhe ajo çka parashikohet në ligj në raport me Inspektoratin e KLD-së në tërësi. Ne kemi parashikuar që Inspektorati ka një rol aktiv në vlerësimin e punës së gjyqtarëve, por në fakt ligji ka harruar të shprehet si vlerësohet vetë Inspektorati, duke filluar nga kryeinspektori dhe deri tek inspektorët. A duhet të vlerësohen, apo jo? Kjo është pyetja që shtrohet. Dhe nëse po, në ç'periudha kohore? Cili është organi që duhet të bëjë vlerësimin e Inspektoratit dhe të kryeinspektorit të KLD-së?

Nga kjo pikëpamje, besoj se qoftë propozimet e ardhura, qoftë edhe shtesat, që mund të bëjmë në këtë drejtim, pa dyshim që do të normojnë dhe do të rregullojnë një mangësi, do të thosha unë, ligjore që ka ligji sot, por që, në fakt, me rregulloren e KLD-së ka disa norma që e normojnë këtë gjë.

Pjesa më e rëndësishme në këtë draft është edhe ajo që ka të bëjë me ndjekjen penale të anëtarëve të KLD-së, por të gjyqtarit, në radhë të parë, sepse pjesa dërrmuese e tyre përpara se të jenë anëtar këshilli, janë gjyqtarë, dhe rastin e ndjekjes penale të tyre ka ardhur momenti që ne duhet ta rishikojmë dhe duhet ta përshtatim me ato ndryshime që kemi bërë para disa kohësh në raport me institutin e imunitetit edhe në Kushtetutë. Ndryshuam Kushtetutën, por realisht nuk prekëm ligjin për KLD-në dhe nga kjo pikëpamje dispozita aktuale që është sot jo vetëm që është e vjetruar, jo vetëm që nuk i përgjigjet gjithë këtij sensibiliteti të madh, por, në fund të fundit, nuk i përgjigjet edhe ndryshimeve kushtetuese që ne vetë bëmë me aq bujë në atë kohë lidhur me kufizimin e imunitetit. Të kesh sot në dispozitë faktin që të ndiqet penalisht një anëtar KLD-je duhet të merret leja te KLD-ja, sigurisht kjo është e papranueshme për të gjithë ne dhe nuk

mund të qëndrojë më. Pa dyshim, ky rregullim ligjor duhet bërë në përputhje me Kushtetutën, ashtu sikurse besoj se biem të gjithë dakord se nuk mund të vazhdojë të qëndrojë gjyqtar ose anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë një gjyqtar ndaj të cilit ka filluar një çështje penale.

Sigurisht, roli i gjyqtarit është themelor në një shoqëri dhe dhënia e drejtësisë ka një shprehje që besoj se e dimë të gjithë “Dhënia e drejtësisë jo vetëm duhet të jetë e tillë, por duhet edhe të duket”. Nga kjo pikëpamje, çfarë mesazhi japim ne përpara opinionit publik kur në krye të tavolinës është një gjyqtar i cili vazhdon të gjykojë, vazhdon të zgjidhë konfliktet mes njerëzve, vazhdon të dënojë edhe keqbërës të ndryshëm, kur vetë ai është në procedim penal, vetë ai është në ndjekje penale? Pra, a mund të pajtohemi ne me këtë lloj mesazhi që vetë sistemi duhet të japë? Sigurisht që jo dhe pa dyshim ajo që propozohet është shumë e rëndësishme, është shumë thelbësore për vetë besueshmërinë që duhet të ketë sistemi. Në rastet kur ndaj një gjyqtari fillohet një procedim penal, ai duhet t’i thotë stop veprimtarisë së vet, jo vetëm si gjyqtar, por edhe si anëtar KLD-je, nëse është, dhe sigurisht duhet të rrijë në pritje të përfundimit të të gjitha procedurave ligjore. Nëse në përfundim të tyre qoftë nga prokuroria, qoftë nga gjykata gjendet i pafajshëm ose çështja mund të pushohet e të tjera, atëherë nuk ka asnjë pengesë që të rikthehet në pozicionin e vet. Por, nëse ndodh e kundërta, sigurisht që ajo ngrirje e funksionit, e detyrës ose pezullim, pa dyshim është shumë e vlefshme, sepse ka shmangur shumë e shumë vendimmarrje, të cilat mund të jepen gjatë kësaj periudhe kohore.

Një moment tjetër i rëndësishëm, shumë shkurt, është edhe rritja e transparencës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ndoshta sot është i vetmi organ ku nuk lejohen mediet, kamerat, nuk merret vesh çfarë bëhet atje brenda, si diskutohet, çfarë dhe si vendoset, si votohet e të tjera. Pa dyshim, rritja e transparencës së vetë veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Drejtësisë është një moment të cilit pa dyshim i ka ardhur koha dhe që ne duhet ta parashikojmë dhe ta detyrojmë këtë organ me ligj, meqenëse vetë nuk po e bën. Ta rrisë transparencën, por edhe në aspektin e dokumentimit të gjithë veprimtarisë së mbledhjes.

Në fund të fundit, Kuvendi i Shqipërisë është organi suprem në këtë vend dhe çdo person, çdo individ mund të futet në faqen zyrtare të Kuvendit dhe aty mund të gjejë të gjitha procesverbalet qoftë të seancës plenare, qoftë të veprimtarisë së komisioneve e me

radhë, ndërsa te Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka një terr të plotë në këtë drejtim dhe, nëse duam sot të shohim se çfarë është diskutuar, bie fjala në mbledhjen e fundit, si është votuar, si është marrë vendimi, nuk mund të marrim dot asnjë informacion në këtë drejtim.

Për ta mbyllur, do të mbështesja plotësisht edhe faktin që ka të bëjë me emërimin e kryetarëve të gjykatave. Duhet të marrë fund praktika e deritanishme ku ka pasur gjyqtarë që janë komanduar dhe kanë ndenjur kryetarë për tre, për katër, për pesë, për gjashtë vjet pa u emëruar. Besoj se arsyet janë të qarta. Duke e mbajtur të komanduar, e ke shumë më kollaj të ushtrosh presion ndaj tij. Ndërsa në rast se kryetari emërohet si i tillë, pa dyshim që krijon një lloj pavarësie nga ky institucion. Kështu që nga kjo pikëpamje edhe ky rregullim që kërkohet t'u bëhet kryetarëve të gjykatave, për të rritur rolin dhe pavarësinë e tyre në administrimin gjyqësor, pa dyshim që ka një rëndësi shumë të madhe në këtë drejtim.

Për ta përfunduar, do të vlerësoja edhe afatin që i vëmë Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të shqyrtuar procedimet disiplinore të propozuara nga ministri, për t'i prerë rrugën asaj që ka ndodhur deri sot, që kërkesat e ministrit flenë në sirtarë me muaj e me vite dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk i merr në shqyrtim procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve të ndryshëm.

Përfundimisht jam plotësisht dakord. I mbështes propozimet dhe, siç e thashë, rezervoj të drejtën, jo vetëm në emrin tim, por edhe në emër të shumë gjyqtarëve, por edhe të faktorëve të tjerë, të cilët janë treguar aktivë gjatë kësaj kohe, që të bëj propozimet përkatëse plus këtyre që kanë ardhur në momentin e shqyrtimit nen për nen.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Subashi!

Po, zoti Ndoka, për procedurë.

**Nard Ndoka** – Faleminderit, zoti kryetar!

Do t'i kërkoja komisionit ta shtynte këtë projektligj për faktin se sot nuk kemi kolegët tanë të Partisë Demokratike, të cilët janë në një bojkot. Është e domosdoshme të ketë një debat politik, profesional në lidhje me këto ndryshime. Unë personalisht i konsideroj ndryshime të cilat cenojnë pavarësinë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe

vetëm nëse i hedhim një sy shumë shpejt nenit 2, ai është mjaft problematik në zbatimin e tij.

Duke e parë në këtë kontekst, unë gjykoj se një reformë e tillë për sistemin e drejtësisë ka nevojë për një debat më të gjerë, ka nevojë për prezencën e deputetëve opozitarë në Komisionin e Ligjeve dhe në parlament, dhe jo të kalojnë kështu në mënyrë të njëanshme si një ligj i zakonshëm.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Po, zoti Fino për procedurë.

**Bashkim Fino** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë jam kundër kolegut tim për një arsye shumë të thjeshtë. E tha zoti Majko në emër të nismëtarëve që ne nuk kemi bërë gjë tjetër veçse rregulloren e KLD-së e kemi ngritur në nivel ligji. Pra, çfarë kemi bërë ne me këtë projektligj që kemi sjellë? Kemi bërë atë që KLD-ja ka shkruar në rregulloren e saj të brendshme dhe që nuk e zbaton realisht, dhe që nuk kemi mundësi të shohim se çfarë bëhet në KLD, të gjithë, si opinioni publik, si ne deputetët, sepse, në fund të fundit, tre përfaqësues dalin nga ne dhe ne mbajmë përgjegjësi për tre përfaqësuesit tanë të Kuvendit. Mund t'i heqim dhe t'i vëmë në çdo kohë, në qoftë se ata nuk e respektojnë rregulloren e tyre. Pikërisht këtë gjë kemi bërë, nga rregullore e kemi kthyer në ligj. Pse duhet të trembet opozita, që ajo që është rregullore duhet të kthehet në ligj? Absolutisht jo, por nuk jam dakord me kolegun parafolës për një arsye shumë të thjeshtë. Ne jemi në proces pune, po punojmë. Ne nuk i kemi thënë opozitës që të bojkotojë Kuvendin apo zyrat e komisioneve përkatëse. Të vijë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Të mbaroj, ju lutem, se unë ju dëgjova, nuk fola!

**Fatmir Xhafaj** – Ju lutem, zoti Ndoka!

**Bashkim Fino** – Zoti kryetar, mbani qëndrim, se jam korrekt!

**Fatmir Xhafaj** – Keni shumë të drejtë, zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Atëherë, nëse kam të drejtë, më lini të flas deri në fund!

**Fatmir Xhafaj** – Ne jemi këtu të gjithë, ndërse vetëm ju jeni nga opozita. Ju dëgjuam me shumë vëmendje! Ju lutem!

**Bashkim Fino** – Ne jemi në punë, jemi këtu në komision. Le të vijmë në seancë plenare, të flasim kur të duan, por për shkak të eksperiencës sime, zoti kryetar, që drejtoj një komision bipartizan të Reformës Territoriale, e kemi pritur opozitën që nga janari deri në prill. Nuk na erdhi, bëmë ndryshim në komision. Po e presim, madje edhe dje i bëmë përsëri thirrje që të vijë. Ne nuk jemi këtu për të pritur opozitën. Ne jemi këtu sepse kemi marrë votën e njerëzve që të drejtojmë dhe të udhëheqim dhe, meqenëse jemi për këtë gjë, i kemi gjërat transparente. Ne nuk e kemi mbledhjen e komisionit tonë dhe të parlamentit siç e ka KLD-ja. Ja ku janë, plot është këtu, me gazetarë, me medien e të gjitha, i kemi mbledhjet transparente. Do të firmoset pasnesër procesverbali i mbledhjes sonë, do të jetë atje prezent dhe nuk kemi frikë nga fjala që kemi thënë dhe ato që do të themi. Prandaj, zoti kryetar, unë kam mendimin të vazhdojmë në mënyrë të rregullt e korrekte dhe këtu jemi, le t'i dëgjojmë kolegët tanë opozitarë. Le të vijmë në seancë plenare. Po të duan, le të vijmë edhe në komision, edhe pasdite sot po të duan, ne përsëri gati jemi për të bërë debat, por nuk bëjmë ndonjë gjë të madhe, madje unë mund të them se bëjmë shumë pak me këtë ndryshim. Duhet bërë edhe më shumë debat për KLD-në, siç tha relatori, sepse, në fund të fundit, po mbështesim votat e njerëzve që na i kanë dhënë më 23 qershor dhe atë pikëpamje, atë ide që ka kërkuar ministri i Drejtësisë nga kjo maxhorancë dhe nga ky parlament, sepse vërtet në shumë veprimtari që ka KLD-ja sot, është një organ që ka pasur kritika të vazhdueshme edhe nga opinioni publik. Meqenëse ka kritika të vazhdueshme, ne duam ta rregullojmë, nuk kemi ndonjë interes personal. Nuk i zgjedhim ne 9 anëtarët, por Konferenca e Gjyqtarëve. Ne nuk jemi gjyqtarë, jemi deputetë. Ne kemi të drejtë të zgjedhim tre veta: një është Presidenti, një është kryetari i Gjykatës së Lartë dhe një është ministri. Ndërsa 9 anëtarë janë nga Konferenca e Gjyqtarëve, pra 3 i zgjedh Kuvendi i Shqipërisë.

E pra, po të donim ne të zgjidhnim tre vetat që kemi, kemi një vit në pushtet dhe mund t'i kishim hequr ata të tre, që nga nënkryetari dhe dy të tjerët, por nuk e kemi bërë një gjë të tillë. Po kërkojmë që rregullorja e tyre të kthehet në ligj, të jetë shumë transparente.

Prandaj, zoti kryetar, të vazhdojmë normalisht të votojmë, të diskutojmë dhe këtu jemi të hapur përsëri. E kam nga eksperiencia, nuk do të vijmë ata edhe pas thirrjes dashamirëse që bëri kolegu parafolës.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Fino!

Besoj se edhe kolegët e tjerë që janë këtu nuk kanë se çfarë të shtojnë më shumë mbi atë që paraqiti zoti Fino. E vlerësoj edhe prezencën e zotit Ndoka, edhe të drejtën e sugjerimit nga ana e tij, por mendoj se është në respekt të Kushtetutës, të ligjit, të Rregullores dhe të vetë interesit të qytetarëve, siç e thanë kolegët, që ne të vazhdojmë shqyrtimin e këtij projektligji.

Secili nga krahët politikë bën zgjedhjen e tij në raport me Kushtetutën dhe me qytetarin. Ne kemi bërë këtë zgjedhje që besojmë se është në interes të qytetarëve.

A ka pyetje? Nuk ka. A ka diskutime në parim?

Po, zoti Ndoka për pyetje.

**Nard Ndoka** – Faleminderit, zoti kryetar!

Meqenëse nisma është marrë nga një grup deputetësh, unë kisha një pyetje për ta: a janë konsultuar paraprakisht me Presidentin e Republikës si institucion, me Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe me Konferencën Kombëtare Gjyqësore, duke qenë se është një ndërhyrje në veprimtarinë e tyre? Konsultat janë normale që të marrin edhe mendimet e tyre, qoftë edhe në formën zyrtare. Në qoftë se kjo nuk është bërë, kërkoj që Komisioni i Ligjeve ta bëjë një gjë të tillë. A ka pasur një përpjekje për konsensus edhe me opozitën, me grupet parlamentare për ta diskutuar paraprakisht si nismë, për t’u bërë pjesë e saj edhe deputetët opozitarë?

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Ndoka!

Meqenëse kjo pyetje më përket mua, jo aq nismëtarëve, sepse ka të bëjë me mënyrën sesi organizohet dhe funksionon puna e këtij komisioni, do të dëshiroja t’jua jepja unë përgjigjen, për shkak se nismëtarët kanë vetëm të drejtën të paraqesin nismën, ashtu siç paraqet nismën edhe një grup shtetasish, sipas Kushtetutës, edhe Këshilli i Ministrave. Pjesa e konsultimit organizohet dhe menaxhohet nga ne si drejtues të këtij komisioni. Natyrisht, kur ka edhe kërkesa të deputetëve, edhe ato shqyrtohen dhe vendosen nga komisioni për t’u proceduar.

Në rastin konkret, zoti Ndoka, dëshiroj të bëj me dije se i jam drejtuar me shkresë zyrtare për të dhënë mendim Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili ka bërë një mbledhje të

posaçme ku e ka shqyrtuar këtë projektligj e njëkohësisht ka sjellë përgjigje me shkrim; Konferencës Gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës Kombëtare të Avokatëve. Për ligjin e shkollës së Magjistraturës, i kam dërguar Shkollës së Magjistraturës dhe prokurorit të Përgjithshëm. Gjithashtu, i jemi drejtuar me shkresë zyrtare për opinion zyrës së Delegacionit Europian, ka sjellë përgjigje; OSBE-së, ka sjellë përgjigje; OPDAT-it dhe të tjerëve.

Kush dëshiron të konsultohet, janë të gjitha këtu në dispozicion. Unë e quaj këtë një proces të konsultuar për sa kohë është kërkuar mendim nga të gjitha këto grupe, nga të gjithë këta aktorë dhe faktorë të rëndësishëm të sistemit dhe institucione ndërkombëtare që asistojnë dhe monitorojnë procesin.

Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Ka diskutime? Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe unë jam një nga firmëtarët e kësaj nisme dhe besoj se ushtrojmë të gjithë të drejtën si deputetë, që na njeh Kushtetuta, për të ndërmarrë nisma legjislative.

Në fakt, ndryshimet që ne propozojmë në ligjin “Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë” janë pjesë e një reforme të gjerë në sistemin e drejtësisë. Personalisht do të preferoja që këtë nismë ta kishte marrë vetë Këshilli i Lartë i Drejtësisë, por, siç e shikojmë, një nismë e tillë nuk është marrë.

Në këtë kuadër, duke qenë se sistemi gjyqësor lëngon, por shumë qytetarë presin prej këtij sistemi, ne si deputetë, si ligjvënës nuk kemi asnjë pengesë për të kontribuar pikërisht në rregullimin e qasjes që duhet të ketë sistemi i drejtësisë ndaj publikut në përgjithësi dhe atyre që marrin shërbime nga sistemi gjyqësor në veçanti.

Të them të drejtën, u ndjeva jashtëzakonisht mirë nga prezantimi që bëri relatori për nismën e një grupi deputetësh, por do të doja gjithashtu të theksoja se në Kuvendin e Shqipërisë kemi kaluar disa ligje kohët e fundit për të rritur transparencën e qeverisjes e pa dyshim KLD-ja duhet të jetë pjesë e kësaj transparence, sepse është qeveria e gjyqësorit, por kemi kaluar edhe një ligj “Për konfliktin e interesit”. Nëse ka një institucion, i cili nuk e kishte të qartë shprehimisht shmangien e konfliktit të interesave është pikërisht Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Për atë kohë sa ne kërkojmë që shmangia e

konfliktit të interesave duhet bërë nga çdo qytetar, nga çdo punonjës i administratës publike, nuk mund të linim jashtë vëmendjes pikërisht Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që ai të merrte vendime shpesh, siç jemi dëshmitarë, në konflikt interesi.

Besoj se qytetarët do ta mirëpresin faktin që ne kërkojmë se Këshilli i Lartë i Drejtësisë të jetë aty për t'i shërbyer drejtësisë, për të pasur një drejtësi sa më funksionale dhe që drejtësia të japë drejtësi, jo për të përzgjedhur ose të zgjidhet vetë në funksionet drejtuese.

Mos harroni, të nderuar kolegë, do të sillja në vëmendjen tuaj rastin e fundit të kryetarit të Gjykatës së Pukës, një kryetar gjykate i cili u kap nga një emision duke bërë korrupsion. Ai ishte gjyqtar i paemëruar, por i komanduar për disa vjet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Ndërkohë, në shumë gjykata ne kemi drejtues gjykate të komanduar.

Kam një pyetje për të gjithë ne: si ka mundësi që Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk ka gjetur kohën dhe mundësinë për të emëruar kryetarët e gjykatave? A mendoni ju se në trupën gjyqësore në Shqipëri nuk ka personalitete, nuk ka gjyqtarë që kanë përvojë, që janë me integritet profesional, me integritet moral për ta merituar vendin e të qenit kryetar gjykate? Si ka mundësi që pjesa më e madhe e gjykatave për një kohë të gjatë kanë qenë dhe vazhdojnë të drejtohen nga kryetarë gjykatash të komanduar? Besoj se është pikërisht e drejta jonë për t'u dhënë fund situatave të tilla dhe çdo qytetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor që ndodhet në juridiksionin ku ai jeton e punon dhe ku merr shërbime, ka të drejtë të ketë një kryetar gjykate të zgjedhur me disa kritere të përcaktuara rigorozisht në ligj.

Meqenëse zoti Ndoka preku pikën 2 të projektligjit, do të doja të sillja në vëmendjen edhe të publikut, meqenëse mund të krijohet një keqkuptim se çfarë kemi sugjeruar ne. Ne kemi kërkuar që në ligj të përcaktohen qartë rastet kur mund të shkarkohet një anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Të nderuar kolegë, të gjithë ne e dimë se në çdo ligj që rregullon organizimin dhe funksionimin e një institucioni, edhe të Kuvendit, edhe për ne deputetët ka rregulla për mbarimin e mandatit dhe për shkarkimin. Ndërsa të vetmit për të cilët nuk ka pasur rregulla sesi mund të shkarkohet një anëtar është pikërisht anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Pra, është më se normale që në ligj të përcaktohet qartë se kur mbaron mandati dhe kur mund të shkarkohet një person. Besoj se është në nderin e sistemit të

drejtësisë që të mos mbajë në gjirin e vet anëtarë të cilët dëmtojnë rëndë reputacionin e gjykatës, shkelin rëndë aspekte profesionale apo etikën, dhe këto gjëra është mirë të thuhën në ligj. A mund ta riformulojmë më mirë pikën 2 të projektligjit? Ne jemi këtu së bashku. Kjo është një nismë e disa deputetëve, por të gjithë janë të mirëpritur, qoftë kolegët e maxhorancës, qoftë kolegët e opozitës, të shprehen dhe të japin opinionin e tyre.

Më lejoni të falënderoj misionin e OSBE-së, i cili ka shprehur opinionin e tij për këtë projektligj, dhe pajtohem me faktin që ky projektligj ka nevojë edhe për një paketë tjetër ligjesh për ndryshim dhe do të ftoja të gjitha institucionet, sidomos KLD-në, Konferencën Gjyqësore, Trupën e Gjyqtarëve dhe Prokurorinë e Përgjithshme, të bëhen nismëtarë për të përmirësuar ligje që rregullojnë funksionin e tyre. Ata më mirë se kushdo tjetër njohin problematikën që kanë hasur, sfidat dhe ne deputetët jemi të gatshëm për t'i mbështetur dhe inkurajuar ata që ligji që rregullon organizimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor, të prokurorisë, Konferencës Gjyqësore, të jetë në interes të një sistemi gjyqësor, i cili duhet të funksionojë ashtu si kërkohet nga standardet, nga Kushtetuta dhe jo të vazhdojë të zvarritet. Kemi gati një vit që jemi në pushtet dhe problemi i sistemit gjyqësor nuk është zgjidhur.

Çështja e fundit që do të doja të theksoja edhe për transparencën e publikut, por edhe për të gjithë kolegët, të cilët mund të kenë pyetje specifike për ne nismëtarët, është transparenca. Nëse ka një gjë që kërkohet me të madhe në një shtet në demokraci, në një shtet të së drejtës, është transparenca. Transparenca në çdo hap që ne hedhim dhe nëse ka një institucion që ka nevojë ta forcojë transparencën, ai është Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Personalisht sot unë nuk jam në gjendje të di sa nga ankesat që qytetarët i drejtojnë Këshillit të Lartë të Drejtësisë për veprime arbitrare të gjyqtarëve etj janë shqyrtuar? Sa prej tyre janë dënuar? Sa prej tyre kanë marrë përgjigje? Pra, ne kemi gjykuar, si çdo institucion që raporton edhe në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që inspektorati duhet të raportojë për të gjitha gjetjet në një vit. Madje mund ta bënim edhe më të shpeshtë raportimin që të dimë se çfarë është bërë me ankesat e qytetarëve. Shumë qytetarë ankohen për veprime arbitrare, abuzuese të anëtarëve të trupës gjyqësore në nivel të gjykatës së parë të rrethit gjyqësor apo të gjykatës së apelit, por a e dimë ne se sa masa disiplinore janë marrë? Sa me vend janë gjetur pikërisht këto ankesa të qytetarëve? Ne i

japim mundësinë qytetarit të ketë akses për të parë si janë shqyrtuar kërkesat dhe ankesat e tij, çfarë masash merr vetë Këshilli i Lartë i Drejtësisë ndaj gjyqtarëve që kanë probleme në sistemin gjyqësor. Prandaj, të nderuar kolegë, duke inkurajuar njëkohësisht nismën për një reformë të thellë të drejtësisë, ne jemi të gatshëm t'u përgjigjemi të gjitha pyetjeve si nismëtarë të këtij projekti dhe besoj se me këtë nismë ne nuk kemi përfunduar reformën në drejtësi, është fillimi i reformës në drejtësi. Është fillim i vonuar, por është i domosdoshëm.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Zoti Manja e ka fjalën.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Edhe unë jam një prej firmëtarëve të këtyre ndryshimeve dhe ndoshta fjala ime pas komenteve të kolegëve, por sidomos të kolegut Fino, do të ishte e tepërt, por nuk mund të rri pa i thënë dy fjalë në lidhje me këtë nismë ligjore.

Unë e kuptoj sensibilitetin e madh të mediave, të opozitës, të vetë KLD-së, por në tërësi të pushtetit gjyqësor, që sot jam i bindur janë gjithë sy e veshë në këtë tavolinë, por përtej këtyre sensibiliteteve, ka një sensibilitet të madh të opinionit publik sot në lidhje me sistemin gjyqësor dhe ne si deputetë të Kuvendit jemi të detyruar të përcjellim në Kuvend pikërisht interesin e publikut, ato sensibilitete që ka publiku sot në lidhje me gjyqësorin dhe rasti më i mirë se si një deputet i Kuvendit mund t'i përcjellë opinionet e publikut në sallën e Kuvendit janë pikërisht nismat ligjore. Kjo nismë ligjore vjen në kohën e duhur, por uroj të mos jetë e fundit, sepse sot me këto ndryshime nuk po synojmë të cenojmë pavarësinë e gjyqësorit dhe as të bëjmë një gijotinë për KLD-në, jo në asnjë mënyrë. Ne sot me këto ndryshime synojmë ta fusim Këshillin e Lartë të Drejtësisë në hullitë e Kushtetutës dhe të zbatimit të ligjit në ushtrimin e funksioneve të tij.

Çfarë sjellë ky projektligj? Në gjykimin tim katër janë shtyllat kryesore të këtyre ndryshimeve:

E para, shmang konfliktin e interesit. Të gjithë e dimë që në mënyrën se si ushtron sot veprimtarinë e tij Këshilli i Lartë i Drejtësisë, më lejoni të them, se ndoshta nuk e teproj, është kthyer në një oligarki gjyqësore me një rreth vicioz të mbyllur, ku anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë po mohojnë njëri-tjetrin, nga shkalla e parë në apel, nga

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në Gjykatën e Tiranës e kështu me radhë. Projektligji synon qartazi shmangien e konfliktit të interesit.

E dyta, është transparenca. Kolegu Fino e tha, madje opozita ka kohë që bërtet me të madhe për rritjen e transparencën në institucionet e shtetit dhe e ftojmë që edhe rastin e KLD-së të bëhet promotore dhe mbështetëse e këtij ndryshimi ligjor.

E treta, është futja në ligj e ndryshimeve kushtetuese që u bënë në lidhje me imunitetin. Për sa kohë këtë të drejtë nuk e gëzojnë as deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, që kanë marrë votat e popullit, të gjithë duhet të jemi të barabartë përpara ligjit. Ky ndryshim synon vendosjen e një parimi të rëndësishëm kushtetues, që është parimi i barazisë përpara ligjit, por që në variantin që vjen projektligji, është kujdesur që të ketë në konsideratë edhe parimin e pafajësisë. Një gjyqtari, ndaj të cilit ka filluar një procedim penal dhe në përfundim, me vendim penal të formës së prerë, deklarohet i pafajshëm, i garanton rikthimin e menjëhershëm në funksionin e gjyqtarit. Pra, harmonizon dy parime të rëndësishme, parimin e barazisë juridike dhe parimin e prezumimit të pafajësisë, që janë parime kushtetuese.

E katërta, lidhet me parimin e sigurisë juridike. Nuk mundet një kryetar gjykate të qëndrojë tre vjet i komanduar, katër vjet i komanduar në krye të një gjykate, siç thotë populli “si lepurit në ferrë”, do të emërohet sot, do të emërohet nesër; do të hiqet sot, do të hiqet nesër, në humorin e një trupe gjyqtarësh që sot janë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

Pra, e përmbledhur, çfarë janë këto ndryshime ligjore? As më shumë dhe as më pak, ato që Bashkimi Europian i ka thënë në progresraportin e vitit 2013. Duhet një gjyqësor i pavarur, i paanshëm, ku të shmanget konflikti i interesit, të rritet transparenca dhe secili t’i nënshtrohet hetimit dhe gjyqimit kur shkel Kushtetutën dhe ligjin, dhe kush ushtron funksionet e gjyqtarit të jetë i garantuar në detyrë, që për sa kohë ushtron Kushtetutën dhe ligjin dhe jep drejtësi, ai të jetë i garantuar në ushtrimin e mandatit dhe të funksioneve të tij.

Të nderuar kolegë të Komisionit të Ligjeve, unë ju ftoj t’i miratojmë këto ndryshime dhe t’ia kalojmë për votim seancës plenare të Kuvendit, duke shpresuar që puna për reformën në drejtësi të fillojë sot dhe jo të mbarojë në shtator e mbresa, por të mos ketë të mbaruar për sa kohë sistemi ka nevojë për ndërhyrje dhe ndryshime.

Gjithmonë në interes të dhënies së drejtësisë, në favor të opinionit publik. Duhet të jemi të qartë: Kuvendi i Shqipërisë është bartës i sovranit popull dhe në krye të interesit ka interesat e publikut shqiptar. Publiku sot e ka shkallën e besueshmërisë të ky gjyqësor zero. Është detyra jonë të bëjmë të gjitha përpjekjet e duhura ligjore për të rritur shkallën e besimit të publikut të gjyqësorit dhe puna fillon me qeverinë e gjyqësorit që është Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Ka ndonjë gjë tjetër nga kolegët?

Në mbyllje të diskutimit për këtë projektligj, dëshiroj të jap dy, tri komente, pa dashur të përsëris shtjellimin shumë të qartë që ju bë këtij projekti në emër të nismëtarëve nga zoti Majko, relatimi i zotit Subashit, ndërhyrjet e kolegëve Hysi, Manja dhe Fino lidhur me përmbajtjen dhe procedurën e shqyrtimit të këtij projektligji, që në vlerësimin tim meritojnë vëmendje.

Së pari, unë, personalisht, por besoj se edhe kolegët e theksuan, mirëkuptoj çdo lloj sensibiliteti, çdo lloj kërkesë për domosdoshmërinë e reformës në drejtësi në një rrafsh shumë më të gjerë se kaq. Absolutisht, të gjithë ata faktorë të brendshëm, brenda sistemit, qytetarë të thjeshtë të këtij vendi e ndërkombëtarë, që trajtojnë çështjen e domosdoshmërisë së një reforme të plotë, gjithëpërfshirëse në sistemin e drejtësisë, kanë shumë të drejtë dhe ne e kemi premtuar këtë gjë, e kemi angazhim, të cilin do ta mbajmë dhe kemi thënë që shumë shpejt në Kuvendin e Shqipërisë do të ketë një komision të posaçëm parlamentar për reformën në drejtësi, një komision që do të synojë të realizojë një proces reforme gjithëpërfshirëse dhe që do të adresojë jo dy, tri ndërhyrje, por një ndërhyrje thelbësore në mënyrën se si funksionon sot sistemi i drejtësisë dhe jo se këtë e do politika, jo se këtë e duan ndërkombëtarët, por sepse këtë e duan qytetarët e këtij vendi, njerëzit e thjeshtë të këtij vendi, që më shumë se çdo gjë tjetër kanë nevojë për drejtësi në këtë vend dhe ky është detyrimi ynë dhe ne do ta përmbushim me sukses. Por të mos ngatërrojmë një gjë të madhe, që është e rëndësishme. Të gjithë ata që spekulojnë me këto pak ndryshime, siç thanë kolegët. Kjo nuk është reforma në drejtësi dhe as pretendojmë se është reforma në drejtësi, sepse po të ishte reforma në drejtësi, sot do të flisnim ndryshe edhe për Këshillin e Lartë të Drejtësisë, atë që kanë thënë ndërkombëtarët, po deshët ju, atë që thotë vetë Këshilli i Lartë i Drejtësisë, për ta riparë

thelbësisht rolin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përbërjen e Këshillit të Drejtësisë, mënyrën se si formohet Këshilli i Drejtësisë dhe mënyrën se si vepron Këshilli i Drejtësisë në raport me interesat e qytetarëve dhe me vetë interesat e gjyqësorit. Por ne nuk jemi këtu për të bërë reformën e plotë. Jo se nuk e kemi të mundshme për ta bërë atë. Ne kemi qenë fare të hapur kur kemi thënë: “Po jemi gati, jemi të përgatitur, po punojmë çdo ditë për atë reformë, ua kemi bërë të qartë edhe partnerëve kontruret e përgjithshme se ku synojmë me atë reformë, kemi marrë mbështetjen e tyre për atë reformë, por po presim një moment të përshtatshëm, që do të thotë që pasi të mbyllet reforma territoriale, një reformë tejet e rëndësishme për vendin, do të fillojmë menjëherë me reformën në drejtësi.

Por dikush mund të shtrojë pyetjen: kur do të bëni një reformë kaq të thellë pse ndërhyjni në këto momente në ligjin e KLD-së dhe në atë të Shkollës së Magjistraturës?

Sepse kemi një situatë emergjente në sistem. Kemi abuzim skandaloz në disa çështje të rëndësishme në sistem për mënyrën se si funksionon Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Po çfarë do të bëjmë do të presim gjashtë muaj, një vit që kryetarët e gjykatave të mos emërohen, por të komandohen? Do të presim që Këshilli i Drejtësisë të rrijë në bunker? Do të presim që gjyqtarë të larë në florinj të vazhdojnë të gjykojnë, ndërkohë që drejtësia jo vetëm jepet, por duhet edhe të besohet? Çfarë duhet të bëjmë ne në këtë situatë emergjente? Patjetër që do të ndërhyjmë dhe këtu është fjala për disa ndryshime të pjesshme, emergjente, që të zhbllokojnë një situatë konkrete. Kjo është domosdoshmëri, është një gjë që është kërkuar, dhe unë gjej rastin ta vlerësoj ee ta mbështesë ministrin e Drejtësisë në deklaratimet e tij publike për këto çështje, nga shumë qytetarë dhe nga vetë aktorët dhe faktorët e sistemit të drejtësisë. Mua më vjen keq që kolegët e Partisë Demokratike nuk janë të pranishëm këtu në këtë mbledhje, ashtu sikundër vlerësoj shumë edhe praninë, edhe ndërhyrjen e kolegut Ndoka, pavarësisht se nuk ndajmë pikëpamje ose qëndrime të njëjta në rastin konkret, për një çështje konkrete, ashtu si do të duhej të ndodhte, mund të ndodhë që edhe midis nesh këtu dhe e kemi provuar me shembuj konkretë që nuk kemi ndarë pikëpamje të njëjta për të njëjtën çështje dhe kemi debatuar dhe votuar në mënyra të ndryshme, jo më me opozitën, e cila sot, nëse është realisht e shqetësuar për ligjin, për sistemin, për gjyqësorin, për qytetarin, do të duhej të ishte këtu dhe jo të anatemonte nga foltorja e SHQUP-it këtë proces. Çfarë thonë

kolegët e opozitës? Që kjo është në kundërshtim flagrant me Rregulloren e Kuvendit, jashtë programit dhe kalendarit të punimeve. Po mirë, ore zotërinj, kaq vështirë e keni ju të hapni faqen e Kuvendit dhe të shikoni që ka një program të miratuar në Kuvend, ku keni qenë edhe ju dhe keni votuar, ku këto projektligje janë pjesë e këtij programi? Por nëse e keni të vështirë të hapni faqen e Kuvendit, ata kanë qenë këtu me ne kur është votuar kalendar dhe këto janë pjesë e projektligjeve që presin për t'u shqyrtuar në kalendar. Pse kaq paturpësisht për të gënjyer publikisht? Po nuk është diskutuar asnjë minutë publikisht, thotë, me asnjë nga aktorët e drejtësisë. Ata që janë celula juaj në KLD duhet t'u kishin thënë që ka vazhduar me orë diskutimi në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Jo një minutë, por me orë kanë diskutuar për këtë ligj. Kanë sjellë dhe vërejtjet, sugjerimet, qëndrimet e tyre, edhe propozime konkrete dhe unë i kërkoj relatorit dhe kolegëve që t'i marrin në shqyrtim, sepse ndërmjet propozimeve që ka sjellë Këshilli ka dy, tri gjëra që përputhen me këtë qëllim që kemi në këtë moment dhe natyrisht një pjesë do të ngelet kur të diskutohet reforma në tërësi. Por, ndërkohë, ju bëra të njohur faktin, në përgjigje të kolegut Ndoka, që ne këtë projektligj ia kemi çuar për konsultim një sërë faktorëve të rëndësishëm të pushtetit gjyqësor, si dhe partnerëve ndërkombëtarë dhe gjejm rastin t'i falënderoj të gjithë ata përfshi edhe vetë KLD-në për përgjigjet që na kanë dërguar.

Nuk është diskutuar asnjë minutë me Komisionin e Venecias, të cilit nuk i ka shkuar asnjë mendim për këto projektligje. Ka ndonjë detyrim në Kushtetutë, në Rregullore që çdo ligj që kalon këtu në Kuvend duhet të shkojë në Komisionin e Venecias? Pastaj këtu nuk ka ndryshime kushtetuese që ne mund t'i drejtohem dhe duhet t'i drejtohem Komisionit të Venecias për të marrë një mendim. Këto janë disa amendamente. Për fat të mirë, një pjesë e tyre, siç e thanë kolegët, i kanë sot në rregulloren e tyre, që ngrihen në fuqinë e ligjit, dhe jo rastësisht nuk janë zbatuar si të tilla, si pjesë të Rregullores. Po për çfarë do t'i drejtohem ne Komisionit të Venecias që të jetë transparente KLD-ja, që gjyqtarët të mos komandohen etj., etj? Kjo do të ishte një turp për ne po ta bënim një gjë të tillë. Do ta çudisim Komisionin e Venecias.

Nuk ka asgjë të përbashkët, thotë opozita, me modelet e funksionimit të drejtësisë të vendeve të BE-së. O Zot! Çfarë po thoni?! Po ne nuk po marrim ligjin në thelb që të themi modeli është apo nuk është i ngjashëm me modelet e tjera. Ne po bëjmë disa

ndërhyrje. Më gjeni dot, meqenëse nuk ka një model tjetër, një model të tillë KLD-je që mbledhet atje 16 orë deri në 3 të mëngjesit dhe asnjë nuk di se çfarë është diskutuar atje. Më gjeni dot një model KLD-je, ku del gjyqtari dhe thotë: “Po, mi falën 50 mijë euro se ne jemi gjyqtarë dhe kemi nevojë për veshmbathje” dhe kur i thonë kush t’i fali, “Mi fali filiani se ai s’e ka problem që të falë edhe një kazino. Gjyqtari i republikës së një shteti! E pse paska problem se i paskan falur 50 mijë euro? Apo se nuk i justifikon dot 2 milionë euro? Dhe ne flasim për modele? A ka modele të tilla që mund të gjendet në ndonjë vend, jo anëtar të BE-së, por në ndonjë vend të planetit? Ku mburren gjyqtarët se kush e ka orën më të shtrenjtë? A janë të gjithë gjyqtarët kështu? Absolutisht jo. Njoh shumë gjyqtarë, edhe shumë nga ju, edhe qytetarët, që nuk kanë asgjë të përbashkët me këtë soj gjyqtarësh. Këta janë një pakicë, por një pakicë që po i krijojnë një imazh negativ gjyqtarit shqiptar. Ajo shumica nuk janë bërë kryetarë. Nuk janë komanduar kryetarë, sepse nuk i shkojnë për shtat kupolës politike të KLD-së. Nuk mbahen nën kontroll, prandaj nuk janë komanduar kryetarë. Kjo është arsyeja se pse shqetësohen disa. Sepse prishet moçali.

Do ta prishim, sepse nuk mund ta lëmë. Ajo afekton drejtpërsëdrejti në atë që është dhënia e drejtësisë dhe besimi te drejtësia. Nuk zgjidh asnjë shqetësim të qytetarëve shqiptarë për funksionimin efikas të sistemit të drejtësisë. Do të qeshin të gjithë qytetarët. Kush e zgjidh shqetësimin e tyre, këta qytetarët që zotërojnë KLD-në si çiflig, që promovojnë vetveten, që nuk guxojnë të ndëshkojnë askënd në radhët e tyre? Për çfarë janë të shqetësuar qytetarët: për faktin që kryetari dhe zëvendësi i tij e kanë shndërruar në bunker, në errësirë të plotë, vendimmarrjen në KLD, me gjithë insistimin e ministrit për ta hapur këtë proces, për të qenë të pranishme kamerat në këtë proces? Për të qenë transparentë me qytetarin e thjeshtë. Kjo e shqetëson qytetarin. Që nuk di se çfarë bëhet me drejtësinë e tij dhe me drejtësinë për të. Kjo është e rëndësishme. Këtë duam të ndryshojmë. Ky qenka mëkati që po bëka maxhoranca? Që ta bëjmë më transparent Këshillin? Ky qenka mëkati që procedimi disiplinor të zhvillohet brenda një muaji? Sepse ka ndenjur dy vjet në sirtarët e KLD-së. Në sirtarin e zëvendëskryetarit të KLD-së, të zgjedhur e të emëruar nga ky Kuvend. Ka, në mos gaboj, vetëm një masë disiplinore për vitin 2013. Ishte insistimi i ministrit të Drejtësisë dhe përfaqësuesit të zgjedhur rishtas nga Kuvendi që e detyroi atë Këshill të marrë dosjet e pluhurosura dhe t’i çojë për shqyrtim. Ky qenka mëkati i madh që po bëjmë ne? Që po i themi: mos i mbaj dy vjet,

por çoji! Vlerësoje, shqyrtoje, por ke detyrimin, se ti ndëshkon orë e minutë, në të drejtën që të ka dhënë Kushtetuta dhe vetë qytetarët, përditë në sallat e tua. Duhet të kesh autopërgjegjësinë, përgjegjësinë ndaj ligjit që t'ndëshkosh edhe veten, kur bën gabime. Çfarë kemi thënë ne? Të pezullohet edhe një gjyqtar, kur ka një çështje të hapur për korrupsion. Jam në dijeni të faktit se ka njerëz që thonë: “Po mirë, more, do të pezullohet një ministër, drejtor etj.”? Nuk është njësoj. Vendimin e ministrit, të Këshillit të Ministrave dhe të vetë Kuvendit, në finale e gjykon ti gjyqtari. Ka një gjykatës që gjykon, po të gabojë, por vendimin tënd nuk e gjykon tjetër njeri: ti je akti final, hapi final. Duhet të kesh jo vetëm aftësinë të japësh drejtësi, por edhe besueshmërinë për ta dhënë atë të merituar. Si mund të jesh i besueshëm, kur ke akuza të tilla të rënda! Mund të mos qëndrojnë, thotë dikush. Dakord, i themi ne: por minimalisht sa të sqarohet çështja, pezullohesh nga detyra. Nëse nuk qëndrojmë dhe drejtësia, ku dhe ti bën pjesë, të jep hakun tënd, do të rikthehesh dhe gjëja do të shkojë në normalitet, duke marrë dhe pagën për kohën që je pezulluar. Cili është mëkati që bëkemi këtu? Se i themi që po të kesh një vepër penale për korrupsion, do të pezullohesh, deri sa sqarohet që ti i korruptuar të mos gjykosësh njeri tjetër për korrupsion. Ti i akuzuar për një vepër penale, të mos gjykosësh një tjetër për këtë vepër penale, në mënyrë që ai qytetari që do të gjykohet prej teje jo vetëm të dëgjojë atë që do të thuash ti, por edhe ta besojë. Kjo është e rëndësishme në një demokraci funksionale, në një shtet të së drejtës, në një pushtet gjyqësor të pavarur, por r të besueshëm nga qytetarët. Natyrisht, do të ishte e mirëpritur edhe prezenca e opozitës dhe e kujtdo tjetër që do të dëshironte të kontribuojë për këto projektligje. Unë dëshiroj t'i rifalënderoj me shumë sinqeritet të gjitha ato institucione ndërkombëtare, institucione të sistemit që kanë dhënë kontributin e tyre në vlerësimin dhe përmirësimin e këtyre projekteve përmes reagimit që kanë bërë ndaj kërkesës sonë për të kontribuar me opinionet e tyre.

Gjithashtu, dëshiroj të falënderoj të gjitha ata gjyqtarë dhe prokurorë, që gjatë kësaj periudhe që e kemi bërë të njohur këtë nismë ligjvënëse na janë drejtuar me emaile, apo drejtpërdrejt, duke na dhënë kontributet e tyre modeste – edhe vërejtje kemi marrë – propozime, sugjerime se si të përmirësojmë më tej këtë dokument. Me këtë rast jo vetëm që i falënderoj këta që kanë kontribuar deri tani, por shtoj cilindo institucion që dëshiron të shprehet para këtij Komisioni, cilindo organizatë të shoqërisë civile, cilindo qytetar,

gjyqtar, prokuror, që nuk dëshiron të kontribuojë me vërejtje, opinione, vlerësime, konsiderata dhe propozime për projektligjet që jemi duke shqyrtuar, t'i paraqesin ato. Ne do t'u japim kohën e nevojshme, duke e votuar sot në parim dhe duke e lënë një ditë tjetër shqyrtimin nen për nen.

Këtu po e mbyllim diskutimin.

Do të votojmë në parim.

Dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet, me një votë kundër.

Faleminderit!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

*Dokument parlamentar*

**PROCESVERBAL**

Datë 16.07.2014, ora 09:30

**Drejton mbledhjen**

**Fatmir Xhafaj – kryetar komisioni**

**Rendi i ditës:**

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8136, datë 13.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës”, të ndryshuar”.

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Silva Caka, Nard Ndoka, Vexhi Muçmataj, Blendi Klosi dhe Tom Doshi.

**Mungojnë:**

Oerd Bylykbashi, Mark Frroku, Arben Ristani, Edi Paloka, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Gjovalin Bzheta, Tahir Muhedini, Mhill Fufi dhe Fatmir Mediu.

**Të ftuar:**

Idlir Peci – përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë

Sokol Pasho – përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë

Edlira Jorgaqi – përfaqësuese nga Ministria e Drejtësisë

**Fatmir Xhafaj** – Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës: projektligji “Për Shkollën e Magjistraturës”.

Të dëgjojmë zonjën Felaj, në emër të iniciuesve të kësaj iniciative, pastaj relatoren, zonjën Caka. Do të vijojmë me procedurën e mëtejshme.

**Ermonela Felaj** – Krahas iniciativës për të paraqitur disa ndryshime në ligjin organik të KLD-së, deputetët e këtij Komisioni kanë paraqitur disa ndryshime edhe në një ligj tjetër, shumë të rëndësishëm, siç është ai “Për Shkollën e Magjistraturës”.

Dëshiroj që në emër të deputetëve propozues të prezantoj projektin e ndryshimeve në ligjin “Për Shkollën e Magjistraturës”, duke dashur të theksoj se për ne Shkolla e Magjistraturës mbetet një institucion shumë i rëndësishëm, për faktin se është burim i parë dhe i vetëm i gjyqtarëve dhe i prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Ligji aktual i ngarkon këtij institucioni detyrën kryesore për formimin profesional të gjyqtarëve dhe e prokurorëve, qoftë kur është fjala për formimin fillestar, qoftë kur është fjala për formimin vazhdues të tyre. Ky institucion ka filluar të funksionojë që të vitin 1996. Në kohë të ndryshme, janë bërë ndryshime në ligjin organik të shkollës, për faktin se ligji fillestar ka qenë i bazuar në dispozita kryesore kushtetuese. Në vitin 1998, doli i nevojshëm ndryshimi i ligjit, sepse në vitin 1998 është miratuar edhe akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, është Kushtetuta e saj.

Pra, nuk është hera e parë që ndërhyhet në ligjin “Për Shkollën e Magjistraturës”. Ndryshimet më të fundit janë bërë në vitin 2005. Me këto ndryshime, ky institucion pësoi ndryshime të konsiderueshme në aspektin organizativ, por jo vetëm, si dhe në funksionet e strukturat drejtuese e akademike. Dua të nënvizoj që të gjitha ndryshimet që janë bërë, kanë pasur si qëllim që të rrisin performancën e kësaj shkolle, e cila në vetvete vijon të ngelet një histori suksesi, për faktin se i ka ofruar pushtetit gjyqësor, por edhe institucionit të Prokurorisë trupa të tërë gjyqtarësh dhe prokurorësh, që me përgatitjen e tyre kanë shënuar ndryshime thelbësore në mënyrën se si gjykohet dhe arsyetohet. Do të më falni për modestinë, sepse unë vetë jam prurje e Shkollës së Magjistraturës, por është një realitet të cilin nuk mund ta mohojmë. Edhe ndërkombëtarët, në të gjitha raportet e progresit për Shqipërinë, kanë konsideruar që kjo shkollë është një arritje pozitive.

Natyrisht, kontribut të padiskutueshëm në këtë pikë ka pasur edhe niveli i lartë profesional i personelit mësimdhënës, si dhe bashkëpunimi i kësaj trupe me organet drejtuese të Shkollës së Magjistraturës.

Edhe pse Shkolla e Magjistraturës ka pasur këtë kontribut kaq të rëndësishëm në furnizimin e sistemit gjyqësor me prurje të reja, vetë sistemi gjyqësor, ashtu siç e diskutuam deri tani, ngelet në nga hallkat e shtetit të së drejtës që ka problematikë dhe ka nevojë për një reformim thelbësor. Janë të përsëritura rastet kur sistemi i drejtësisë, edhe aktorët e tij, përfshirë edhe gjyqtarët apo dhe prokurorët, apo dhe vetë mënyrën se si është organizuar ky sistem, janë vënë në dukje si struktura që duhet të merren në shqyrtim, për sa i takon rritjes së elementeve të tilla, si transparenca, efektiviteti, llogaridhënia dhe profesionalizmi. Në këtë pikë, do të desha të shkoj diçka për opinionin publik. KLD-ja apo institucionet e tjera nuk janë institucione superiore, që mund të qëndrojnë mbi ligjin, që mund të qëndrojnë mbi sovranin. Nga këtu lind edhe legjitimiteti ynë për të bërë ndryshime të tilla, për të mos qëndruar indiferentë ndaj problemeve që të gjithë i shohim dhe na shqetësojnë. Mungesa e transparencës dhe e profesionalizmit brenda radhëve të sistemit është konstatuar se prek drejtpërsëdrejti nivelin e llogaridhënies dhe efektivitetin e strukturave të sistemit, i cili gjithnjë e më shumë po shihet që është një sistem i mbyllur, korporativ, i cili merr në mbrojtje vetveten. Në të tilla rrethana, profesionalizmi i deri më sotëm, që është konstatuar me të drejtë në Shkollën e Magjistraturës, haptazi dhe pa kundërshti, duhet të pranohet se është meritë e personelit të kësaj shkolle.

Po ashtu, roli vendimtar që ka personeli mësimdhënës në organizimin, përgatitjen e konkurseve të pranimit në Shkollën e Magjistraturës, është një tjetër element që duhet të ruhet dhe të promovohet në vijim nga kjo shkollë. Nga miratimi i ndryshimeve më të fundit që janë bërë në ligjin organik të Shkollës së Magjistraturës, aktualisht ka kaluar gati një dekadë. Për këtë arsye ne mendojmë që është e nevojshme që të nxisim disa ndryshime të tjera në dispozitat e ligjit, me qëllim që të vijojë të ruhet niveli profesional i Shkollës dhe njëkohësisht të shmangim Shkollën, sa të jetë e mundur, nga ato probleme që ka sistemi drejtësisë dhe që në një mënyrë apo në një tjetër e prekin edhe vetë shkollën.

Ne kemi paraqitur një projekt që përmban, së bashku me dispozitat transitorë dhe ato të hyrjes në fuqi, 13 nene. Nëpërmjet dispozitës së nenit 1 të këtij projektligji, synojmë që përbërja e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës të reformohet, duke propozuar që numri i anëtarëve nga këshilli pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës që përfaqësohen në Këshillin Drejtues të Shkollës së Magjistraturës të rritet nga dy vetë, që është aktualisht, në katër.

Besojmë se shtimi i numrit të pedagogëve të brendshëm në përbërjen e Këshillit Drejtues të Shkollës duhet parë si një ndryshim që synon të rrisë cilësinë e organizimit të shkollës, si dhe të shmangë gjithë faktorët joprofesionalë në përmbushjen e atyre objektivave që i ka vënë vetes kjo Shkollë.

Këto propozime synojnë të reformojnë dhe mënyrën e saktësimit të përfaqësuesve të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë në Këshillin Drejtues të Shkollës, duke synuar edhe këtu rritjen e transparencës dhe të pjesëmarrjes së të gjithë gjyqtarëve e prokurorëve në procedurat përzgjedhëse. Sipas ligjit aktual, në Këshillin Drejtues të Shkollës së Magjistraturës marrin pjesë një gjyqtar dhe një prokuror, që aktualisht caktohen nga KLD-ja dhe Prokurori i Përgjithshëm. Kuptohet që KLD-ja, edhe pse është qeveria e gjyqësorit, nuk e njëjta gjë me trupën e të gjithë gjyqtarëve që veprojnë në Republikën e Shqipërisë. i njëjti konstatim vlen edhe për pjesën tjetër: atë të prokurorëve. Pra, ndonëse është organi kryesor në sistemin e prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm i vetëm nuk përfaqëson gjithë mbledhjen e përgjithshme të prokurorëve. Kështu që kemi propozuar që propozimet për qenien anëtar në Këshillin Drejtues të Shkollës së Magjistraturës të një gjyqtari dhe të një prokurori të vijnë nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore, si dhe nga mbledhja e përgjithshme e prokurorëve.

Një ndryshim tjetër që kemi propozuar në nenin 1 të projektit: vihet re që pjesë e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës është dekani i Fakultetit të Drejtësisë. Panorama e re e arsimit të lartë universitar në Shqipëri ndryshon nga ajo e viteve kur u hartua ligji i vitit 1996. Në rast se në vitin 1996 Fakulteti i Drejtësisë, pranë Universitetit të Tiranës, ishte i vetmi institucion që ofronte formim universitar në fushën e së drejtës, tani strukturat akademike janë shtuar. Fakultetet publike dhe private janë me dhjetëra që prej vitit 1996. E kemi gjetur si diskriminues faktin që në Këshillin Drejtues të Shkollës së Magjistraturës institucionet e formimit akademik në fushën e së drejtës të

përfaqësohen detyrimisht dhe vetëm nga dekani i Fakultetit të Drejtësisë, pranë Universitetit të Tiranës. Ky parashikim ligjor i 20 viteve më parë i vendos në pozita të pabarabarta një sërë institucionesh të tjera publike dhe private të arsimit të lartë. Në gjykimin tonë, Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë, një organ epror, do të përfaqësonte një strukturë me reputacion të gjithëpranuar dhe me nivel profesional të lartë të tillë që mund të ofrojë garanci për një përzgjedhje sa më dinjitoze në Këshillin Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Vlerësojmë, gjithashtu, se duhet të ketë një reflektim dhe një reformim në lidhje me kushtet dhe kriteret ligjore që duhet të gëzojë drejtuesi i Shkollës së Magjistraturës. Përvoja e deritashme e përzgjedhjes së drejtuesve të kësaj Shkolle nga radhët e gjyqtarëve dhe të personelit akademik është një eksperiencë që duhet të ruhet dhe promovohet. Drejtori i Shkollës së Magjistraturës, sipas ligjit në fuqi, është funksionar i lartë që kryen detyra të rëndësishme edhe të natyrës akademike. Konkretisht, sipas nenit 7 të ligjit, drejtori i Shkollës së Magjistraturës drejton trupën pedagogjike, bashkërendon punën me ta, miraton programet mësimore të çdo lënde dhe kontrollon zbatimin e tyre dhe cilësinë e mësimdhënies, si dhe i propozon Këshillit drejtues edhe kandidatët për pedagogë të Shkollës së Magjistraturës. Këto detyra të drejtorit të Shkollës së Magjistraturës janë të njëjta në fakt me detyrat që kryen çdo dekan fakulteti në universitetet publike apo private. Nëse në ligjin “Për arsimin e lartë” dekani i fakultetit, si autoriteti më i lartë drejtues, duhet të ketë të paktën titullin “profesor i asociuar”, ose gradën shkencore “doktor”, të fituar në universitete perëndimore, natyrisht edhe drejtori i Shkollës së Magjistraturës nuk mund të qëndrojë më poshtë sesa dekan i çdo fakulteti, pra duhet edhe ai të përmbushë të njëjtat kriterë. Kështu që nga kjo pikëpamje, është e papranueshme që vetë neni 7 i ligjit në fuqi, ndërsa parashikon këto detyra të natyrës akademike për drejtorin e Shkollës së Magjistraturës, në paragrafin e parë të nenit 7 ka parashikuar kriterë aspak të natyrës akademike për një funksionar të tillë. Sipas ligjit ekzistues, drejtori i shkollës së Magjistraturës mund të emërohet kushdo që ka dhjetë vjet punë si gjyqtar ose prokuror, çdo jurist me mbi 15 vjet punë, pa qenë për asnjë moment i përfshirë në procesin e mësimdhënies, për më tepër, të ketë minimumi një gradë shkencore. Pra, shihet qartë se ka një mangësi ligji në këtë pikë që natyrisht nuk duhet lënë më e tillë.

Po ashtu, parashikimi i shprehur i ndalimit të përzgjedhjes së një kandidati për drejtor të Shkollës së Magjistraturës nga radhët e subjekteve që kanë ose kanë pasur një aktivitet të spikatur politik, do të ndikojë pozitivisht në mënjanimin e ndikimeve politike në funksionimin e kësaj strukture të formimit profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Të mos harrojmë, ndonëse është koha e magjistraturës, duket diçka e largët prej politikës, politika e ka mendjen te shkolla e Magjistraturës, sepse është shkolla nga e cila do të dalin gjyqtarët dhe prokurorët. Prandaj duhet t'i japim atë rëndësi që meriton kjo shkollë.

Në kohën e miratimit të ligjit organik të Shkollës së Magjistraturës në vitin 1996 zgjedhja e drejtorit të shkollës nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë bënte të mundur përfshirjen në këtë proces qoftë të përfaqësuesve të gjykatave, qoftë të prokurorisë. Por më vonë sistemi i drejtësisë ka pësuar ndryshime dhe në Këshillin e Lartë të Drejtësisë përfaqësohen gjyqtarët kryesisht, nuk përfaqësohen prokurorët.

Me gjithë këto ndryshime që kanë ndodhur, qoftë edhe ato të fundit në vitin 2005, për sa i takon rolin dhe funksionimit të KLD-së, në ligjin e Shkollës së Magjistraturës nuk është adresuar kjo pikë, që të përfaqësohet edhe prokuroria në zgjedhjen e drejtorit të Shkollës së Magjistraturës. Edhe sot KLD-ja parashikohet nga ligji si organi që e përzgjedh drejtorin e shkollës, me propozim të këshillit drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Me qëllim shmangien e mungesës së përfaqësimit të sistemit të prokurorisë në strukturën vendimmarrëse, që emëron drejtorin e Shkollës së Magjistraturës, natyrisht, duke dashur që t'i bëjmë pjesëmarrës edhe prokurorët në këtë proces, për sa kohë që nuk jemi edhe përpara një kompetence kushtetuese të KLD-së, se nuk e parashikon Kushtetuta si kompetencë të KLD-së emërimin e drejtorit të Shkollës së Magjistraturës, ne propozojmë që zgjedhja e drejtorit të Shkollës së Magjistraturës të bëhet me votim të hapur nga ana e këshillit drejtues të shkollës.

Ky element i propozuar nga ana jonë, synon të rrisë edhe pavarësinë në funksionimin e Shkollës së Magjistraturës, duke i ofruar kësaj shkolle mundësinë për vetadministrim organizativ sa më të plotë. Shkolla është autonome, vetregullohet, vetorganizohet.

Në këtë projektligj ne propozojmë që statusi i drejtorit të Shkollës së Magjistraturës të gjejë parashikim të hollësishëm dhe statusi i drejtorit të Shkollës së Magjistraturës njehsohet me statusin e anëtarit të Gjykatës së Lartë.

Një tjetër risi në këtë drejtim, që vlerëson se do të kontribuonte në përcaktimin dhe garantimin e një statusi ligjor të drejtuesit të Shkollës së Magjistraturës janë edhe parashikimet në mënyrë të shprehur në ligj të rasteve kur bëhet lirimi dhe shkarkimi nga detyra i drejtorit të shkollës së Magjistraturës. Natyrisht, kjo masë legislative do të vendoste kufizime në diskrecionin e organit epror, në subjektivizmin eventual për largimin ose shkarkimin nga detyra të drejtorit të shkollës.

Në të njëjtën linjë argumentimi konsiderojmë edhe parashikimet e detajuara të të gjitha detyrave që do të ketë drejtori i Shkollës së Magjistraturës, pasi edhe ky si element e forcon llogaridhënien e vetë drejtorit para strukturave drejtuese të shkollës dhe njëkohësisht, edhe për sa i takon përmbushjes së detyrimeve në lidhje me këshillin pedagogjik.

Projektligji, veç kritereve që vendos për drejtorin e Shkollës së Magjistraturës, vendos kritere edhe për përzgjedhjen e trupës pedagogjike, si të pedagogëve të brendshëm të shkollës, edhe të pedagogëve të jashtëm, duke synuar rritjen e cilësisë të mësimdhënies në Shkollën e Magjistraturës. Edhe në këtë rast vlen të përmendet një konstatim, se detyrat dhe rregullat për funksionimin e këshillit pedagogjik të shkollës aktualisht rregullohen në rregulloren e shkollës. Ndërkohë, me ndryshimet që sjellim në ligjin e Shkollës së Magjistraturës, këto detyra i marrim nga rregullorja dhe i vendosim në ligj dhe i parashikojmë si shumë të rëndësishme për të qenë në ligj dhe për t'u zbatuar pikë për pikë, ashtu sikurse i parashikon ligji.

Një parashikim të shprehur në ligj gjejmë edhe rregullat e procedimit disiplinor të kandidatëve për magjistratë. Ky tagër tanimë i jepet këshillit drejtues të shkollës.

Projektligji parashikon që pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm të emërohen nga këshilli drejtues, me propozim jo vetëm të drejtorit, siç ka qenë, por me propozim edhe të vetë këshillit drejtues të shkollës. Projektligji po ashtu propozon ndryshime edhe për sa i takon përmirësimit të procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për magjistratë, duke futur testimin me gojë të aftësive social-psikologjike të tyre dhe të shëndetit mendor, është një risi për këtë ligj.

Unë do të them dy fjalë në lidhje me dispozitat tranzitore, sepse besoj se do të ketë diskutim në këtë pikë. Në projekt parashikohet që efekti i ligjit në rregullimin e marrëdhënieve të këshillit ekzistues pedagogjik, drejtues dhe personeli tjetër, ligji të ketë fuqi prapavepruese. Tani është pak e veçantë, sepse dihet se ligji penal është ai që kryesisht ka fuqi prapavepruese dhe kur sjell efekte favorizuese, por edhe ligje të tjera mund të kenë efekt prapaveprues, natyrisht, kur bëhet fjalë për ligje që ndërhyjnë për të rregulluar situata të paligjshme, për ligje që interpretojnë anë të errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm dhe në ndonjë rast tjetër, kur paraqitet e domosdoshme të shmangen pasoja të rënda negative ose edhe të pandreqshme.

Prandaj, si rregull, efekti prapaveprues i ligjeve nuk mund të zbatohet, me përjashtim të rasteve, kur kërkohet të krijohen favore ose kur imponohet nga prania e interesit publik të rëndësishëm. Pikërisht, prania e interesit publik të rëndësishëm imponon ligjvënësin që të ndërhyjë në ligje duke iu dhënë atyre edhe fuqi prapavepruese.

Nisur nga kjo, ne kemi menduar që projektit, të cilin kemi propozuar, t'i japim fuqi prapavepruese në kuptimin që, nëse në trupën e Shkollës së Magjistraturës ka pedagogë të brendshëm, apo të jashtëm, qoftë edhe drejtuesi i shkollës, që nuk plotëson kriteret e emërimit në detyrën përkatëse, natyrisht këto të mos jenë më pjesë e këshillit pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës.

Në projekt parashikohet, gjithashtu, që konkursi për vitin 2014 për rimarrjen e kandidatëve për magjistratë, të mos zhvillohet, por të zhvillohet vitin e ardhshëm, në vitin 2015, sepse gjatë kësaj kohe është vërejtur se ka pasur shumë problematikë për emërimin e gjyqtarëve, po them të gjyqtarëve, sepse 3 vitet e fundit shkolla nuk ka marrë ose nuk ka përgatitur prokurorë ngaqë nuk ka pasur kërkesa për përgatitje prokurorësh, meqenëse nuk ka pasur në sistemin e prokurorisë vende të lira për rekrutimin e tyre, ndërkohë që problematika ka qenë e ndryshme, për sa i takon pushtetit gjyqësor. Pra, edhe pse shkolla ka vazhduar të përgatisë gjyqtarë, këta gjyqtarë kanë ngelur për një kohë shumë të gjatë të paintegruar në sistemin gjyqësor, pra, të paintegruar në detyrën për të cilën ata marrin formimin në Shkollën e Magjistraturës. Natyrisht, ky ngelet problem i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili me sa duket edhe në këtë rast nuk ka vlerësuar drejt sa kanë qenë nevojat e gjyqësorit për gjyqtarë të rinj. Ky veprim në këtë mënyrë i ka sjellë dëm shtetit, sepse sipas ligjit aktual të Shkollës së Magjistraturës shteti është i detyruar t'i emërojë

kandidatët për magjistratë. Në momentin që nuk arrin t'i emërojë në detyrë, është i detyruar t'u japë pagën atyre. Kështu që ne kemi paguar kandidatë të tërë për magjistratë, gjyqtarë, në një kohë që ato nuk kanë qenë në detyrë.

Në përfundim të këtij relatimi, që shpresoj të mos ketë qenë aq i gjatë pas gjithë atyre që thamë, unë do t'ju ftoja që të marrim pjesë aktivisht natyrisht në diskutimin e këtij projekti dhe të miratojmë në parim të tilla ndryshime, sepse janë bërë, ju siguroj, me gjithë kujdesin e duhur, për të rritur cilësinë e shkollës, për të ruajtur ato vlera që kjo shkollë ka arritur të krijojë deri më sot.

Ju faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zonja Felaj, për ekspozenë e nismës në emër të nismëtarëve!

Besoj se do të kemi një vlerësim të përmbledhur të zonjës Caka, në cilësinë e relatores së projektligjit.

**Silva Caka** – Faleminderit, zoti kryetar!

Me sa duket deputetët iniciatorë e kanë aq për zemër këtë projektligj sa i ezauruan në mënyrë shteruese të gjitha risitë e projektligjit dhe në cilësinë e relatores mua më ngelet vetëm t'i përgëzoj për këtë punë të mrekullueshme që po bëjnë mbi ligjin e Shkollës së Magjistraturës, pasi të gjithë e dimë se Shkolla e Magjistraturës është institucioni i vetëm përgjegjës për formimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve, dhe si e tillë konsiderohet edhe gjeneza e formimit jo vetëm profesional, por edhe personal të këtyre, dhe shpresoj shumë që këto ndryshime në ligj të sjellin në mënyrë direkte, të prodhojnë një trupë gjyqtarësh, të cilët do të bëhen mbrojtësit më të mëdhenj të kauzës së luftës kundër korrupsionit në sistemin e drejtësisë dhe të prodhojë gjyqtarë dhe kryetarë gjykatash, të cilët betohen mbi Kushtetutën dhe jo mbi fotografinë e ndonjë lideri partie politike.

Në fund, në cilësinë e relatores, doja të rezervoja të drejtën për të shprehur ndryshimet, kur të vijmë në diskutimin nen për nen.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zonjës relatore, për vlerësimin dhe komentet dhe për faktin që do të ndërhyjë në vlerësimin nen për nen!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Deshët një koment shtesë?

**Ermonela Felaj** – Më falni për këtë ndërhyrje! Unë desha të vë në dukje se ne për këto ndryshime kemi konsultuar edhe trupa të tjera, pra u kemi kërkuar mendim konkretisht këshillit pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës, i kemi kërkuar mendim OSBE-së, dhe mua më vjen mirë të konstatoj që përgjithësisht dhe kryesisht të dyja këto trupa janë dakord me ndryshimet e sjella në këtë projekt.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Ka pyetje? Nuk ka. Ka diskutime?

Ju lutem, njoftoni kolegët!

Para se të votojmë, dëshiroj të them dy-tri gjëra shumë shkurt. Nëse do të më pyesnit pse ky ndryshim në projektligjin “Për Shkollën e Magjistraturës” dhe cila është e përbashkëta apo e veçanta, në raport me projektligjin e mëparshëm, do ta përmbledhja shumë shkurt duke thënë se, ndërsa në projektligjin e mëparshëm qëllimi është që një gjendje bllokuese, të virusuar keq, kërkojmë ta shërojmë sado pak për ta shpëtuar, për t’ia larguar atë virus negativ, në këtë rast po ju them se dëshirojmë që shkolla të mos marrë të njëjtin virus. Ne duam që nga gjendja moçalore që është, ta pastrojmë për ta bërë të pastër, këtë duam që ta ruajmë të pastër, që të mos priset, ky është qëllimi, që do të thotë se ne kemi gjithë respektin, vlerësimin pozitiv për shkollën në këto vite, për atë çka ajo ka ofruar.

Unë i vlerësoj shumë pozitivisht dhe falënderoj këshillin pedagogjik të shkollës për komentet që ka bërë, për sugjerimet dhe për propozimet, të cilat do t’i shqyrtojmë me shumë kujdes gjatë shqyrtimit nen për nen, ashtu siç vlerësoj edhe sugjerimet produktive të disa organizatave, përfshi edhe ato ndërkombëtare.

Gjithashtu, edhe në këtë rast, ftoj të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë, organizata të shoqërisë civile, gjyqtarë, prokurorë, dhe veçanërisht magjistratët, që kanë përfunduar atë shkollë të nderuar dhe ata që janë duke e vazhduar, qytetarë, studentë që dëshirojnë të hyjnë në atë shkollë, që të shprehin vlerësimet, opinionet dhe propozimet përkatëse në këtë periudhë, deri në shqyrtimin nen për nen, dhe nga ana jonë do të vlerësohen me shumë seriozitet.

E mbyllim këtu diskutimin dhe shqyrtimin e këtij procesi, për të pasur një kohë të dytë për shqyrtimin e tij nen për nen, ashtu sikundër u propozua edhe nga kolegët dhe ramë dakord që është e nevojshme për të reflektuar për përmbajtjen e këtyre projekteve të rëndësishme, për të reflektuar për sugjerimet, propozimet që kanë ardhur rreth këtyre dy projekteve, dhe për të mirëpritur dhe reflektuar ndaj çdo kontributi të mundshëm që do të synojë përmirësimin e këtyre projekteve gjatë shqyrtimit nen për nen.

Për ta mbyllur procesin, ju lutem, të votojmë projektligjin në parim.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim edhe ky projektligj, për të vazhduar pastaj nen për nen.

Këtu e mbyllim diskutimin për sot, për këto tre projektligje të rëndësishme.

Shumë faleminderit kolegëve, për kontributet!

Faleminderit përfaqësuesve të ministrisë, për kontributin dhe për prezencën!

Faleminderit medias, që e ndoqi nga afër, në mënyrë transparente, këtë mbledhje të komisionit!

Faleminderit të gjithë atyre që kanë kontribuar me opinionet e tyre për projektligjet!

Mirë u takofshim gjatë shqyrtimit nen për nen!

Fundjavë të mbarë!